

ISSN 1857-6443
9 771857 644006

SHËNDETËSI

Sfidat e fëmijëve me aftësi të kufizuara

Fq.6



EKONOMI

Gjysma e eksportit nga investitorët e huaj

Fq.8



UÇK dhe NATO detyruan kapitullimin e Millosheviçit

Fq.16



Koha

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XIII · Numri 3617 · e hënë, 25 mars 2019

15°C | 20°C

15 DEN



KOHA për sport

Fq.12-15

ANALIZË

Lufta e drejtë e Perëndimit për Kosovën



Njëzet vjet pas fillimit të fushatës së Paktit NATO, në politikën dhe mediat në Serbi (me përjashtime shumë të rralla, që mund të numërohen me gishta dore), po ndodhë përpjekja që gjithsesi është e paracaktuar për dështim, e revidimit dhe e ndryshimit të ngjarjes madhore të pranverës së vitit 1999-të.

Fq.2

KRONIKË

Vrasja e 7 vjeçarit në Basel, a dështuan autoritetet zvicerane?

Fq.16-17

RAJON

“L'Osservatore Romano”: Do të kemi eksod shqiptar si në '90!

Fq.16



PREMTIMET E KANDIDATËVE PËR PRESIDENT

FONTANË DËSHIRASH!



Në fushata zgjedhore ndodhë që të jepen premtime jashtë ingerencave që mund të ketë presidenti i shtetit. Habit fakti kur këto premtime jepen nga profesor universitar që mirë e dinë se premtimet e dhëna para qytetarëve nuk mund t'i realizojnë nëse marrin postin e presidentit të shtetit

Fq.3

Pas Zaevit, edhe Angjushev me premtime

Tetovë, 24 mars - Vazhdojnë në pafundësi premtimet për banorët e fshatit Xhermë dhe Poroj se problemi me ndërtimin e digave do të zgjidhet. Nëse në vizitën e vitit 2017 ishte kryeministri Zoran Zaev që premtoi zgjidhje të këtij problemi, kësaj radhe ka qenë zëvendësi i tij, Koço Angjushev që ka dhënë sërish premtime, duke sqaruar se për problemin në fjalë tashmë është diskutuar me kryetarët e komunave të

Pollogut në Ministrinë e Transportit. “Në ne qeveri punojmë në maksimum që ky rajon të mbrohet nga vërshimet. Në këtë drejtim, në Ministrinë e Transportit dhe Lidhjeve mbajmë një mbledhje me kryetarët e komunave të Pollogut, ku isha i pranishëm edhe unë, por edhe institucione tjera që kanë të bëjnë me atë problem. U pajtuam për të bërë analiza dhe se çfarë projektesh kemi...”

Fq.7



ANALIZË

LUFTA E DREJTË E PERËNDIMIT PËR KOSOVËN

Nga Blerim Shala



Njëzet vjet pas fillimit të fushatës së Paktit NATO, në politikën dhe mediat në Serbi (me përjashtime shumë të rralla, që mund të numërohen me gishta dore), po ndodhë përpjekja që gjithsesi është e paracaktuar për dështim, e revidimit dhe e ndryshimit të ngjarjes madhore të pranverës së vitit 1999-të. Askund nuk përmenden krimet e rënda që ishin bërë ndaj shqiptarëve të Kosovës

Okupimi i Kosovës nga Serbia ka nisë me krime, në atë vjeshtë të vitit 1912-të, dhe ka marrë fund me krime, në pranverën e vitit 1999-të.

Ka ngjarje të mëdha historike të cilat politika nuk mund t'i ndryshojë, pa marrë parasysh se çfarë ndodhë më pas, apo, çfarë rrjedhe merr një politikë.

Këto ngjarje pra kanë një vlerë të pakontestueshme, e cila asnjëherë nuk mund të vihet në dyshim.

E tillë është Lufta e Dytë Botërore, për shembull. Vullën e kimit të madh dhe të turpit të përjetshëm kanë marrë Kampet e Përqendrimit, por edhe të gjitha tragjeditë e shkaktuara në ato gjashtë vitet e luftës së madhe, me adresë shumë të qartë të përgjegjësisë historike, politike, ligjore, morale.

E tillë, gjithsesi, është edhe Lufta në Kosovë, në vitet 1998, 1999, që arriti pikën e saj më të lartë me fushatën 11 javore të Aleancës Veri-Atlantike që nisi me 24 mars, të vitit 1999-të, në orët e mbrëmjes, apo, pikërisht njëzet vjet më parë.

Ishin të ndarë, në mënyrën më kategorike të mundshme, ata që ishin në anën e drejtë, në këtë luftë tragjike, dhe ata që ishin në anën e gabuar.

Mbase, në këtë luftë të katërt që kishte përcjellë zhbërjen e ish-RSFJ-së dhe krijimin e shteteve të reja në atë hapësirë e dikurshme të përbashkët politike dhe shtetërore, në atë harkun kohor prej qershorit të vitit 1991 deri në qershorin e vitit 1999-të, lufta e Kosovës ka qenë më e qarta kur bëhej fjalë për përgjegjësinë e një shteti dhe një pushtetit (të Serbisë dhe të pushtetit të saj), për shpërthimin e një lufte.

Për më shumë, dihet që ky pushtet, me Slobodan Millosheviqin në krye si një lider të pakontestueshëm të Serbisë në dymbëdhjetë vitet e mëparme (që prej vitit 1987-të), kishte refuzuar të pajtohej me Marrëveshjen e Rambouilletit (shkurt, mars, 1999), e cila i jepte fund luftës, dhe ofronte një

paqe të garantuar nga 25 mijë ushtarë të Paktit NATO.

Me këtë kundërshtim të tij, në realitet, ishte Millosheviqi ai që nisi luftën me Paktin NATO.

Ishte i gatshëm pra të luftojë me gjithë Perëndimin, e të mos hiqte dorë nga Kosova, apo nga vendi i krimeve të njëpasnjëshme të të gjitha pushteteve të Serbisë, në periudhën prej vjeshtës së vitit 1912-të, deri në pranverën e vonë të vitit 1999-të.

Okupimi i Kosovës nga Serbia ka nisë me krime, dhe ka marrë fund me krime ndaj shqiptarëve të Kosovës.

Nuk ka dhe nuk mund të ketë histori tjetërfare të fatit të popullit shqiptar në Kosovë, në atë shekullin e gjatë të okupimit të Serbisë.

Sikurse që nuk ka dhe nuk mund të ketë histori ndryshe, ('alternative'), të kobit të popujve evropianë gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Njëzet vjet pas përfundimit të kësaj lufte, në vitin 1965-së, në politikën dhe mediat e Gjermanisë Federale, ka qenë absolutisht e qartë se çfarë ka ndodhë në Luftën e Dytë Botërore.

Për më shumë, kjo Gjermani e re, së bashku me Francën dhe shtetet tjera të Evropës Perëndimit, pati bërë zotimin, përmes një bashkëpunimi dhe miqësisë të paparë në historinë evropiane, që kurrë më të mos ketë luftë në Evropën Perëndimore.

Bashkimi Evropian dhe Pakti NATO janë garanca sipërore të këtij zotimi.

Njëzet vjet pas fillimit të fushatës së Paktit NATO, në politikën dhe mediat në Serbi (me përjashtime shumë të rralla, që mund të numërohen me gishta dore), po ndodhë përpjekja që gjithsesi është e paracaktuar për dështim, e revidimit dhe e ndryshimit të ngjarjes madhore të pranverës së vitit 1999-të.

Askund nuk përmenden krimet e rënda që ishin bërë ndaj shqiptarëve të Kosovës.

Askund nuk sheh një shenjë më të vogël të pendesës për këto tragjedi të shkaktuara viteve të luftës. E lëre më gatishmëri për kërkim faljeje.

Sikur dikush në Perëndim, në kryeqendrat politike të tij, para dy decenieve, do të thoshte që Kosova dhe Serbia nuk do të pajtoheshin, si shtete, dhe si popuj, edhe njëzet vjet pas kësaj lufte, pakku-sh do të ishte i gatshëm të dakordohej me këtë parashikimin e tij.

Ky është realiteti.

Edhe këtu, dihet fare mirë se kush nuk ka dashtë Marrëveshjen e cila do t'i jepte fund një herë e përgjithmonë konfrontimit të madh historik dhe politik në mes të Kosovës dhe Serbisë.

Kosova ka qenë gati për këtë Marrëveshje.

Sidoqoftë, në këtë ditë kur shënojmë njëzet vjetorin e fillimit të luftës së Paktit NATO për shpëtimin e këtij vendi dhe këtij populli, duhet thënë që ne do ta kujtojmë përjetë këtë luftë të cilës i priu SHBA-ja me aleatët e saj në Aleancën Veri-Atlantike.

Po ashtu, ne shqiptarët e Kosovës kurrë nuk mund t'i harrojmë gjithë ato vuajtje, gjithë atë pikëllim, gjithë atë tragjedi të cilën e përjetuam në luftën e viteve 1998, 1999.

JANË TRI ARSYE KRYESORE PSE NATO HYRI NË LUFTË PARA DY DEKADASH

Në një postim në Facebook Albin Kurti tregon arsyet pse NATO intervenoi në Kosovë. "20 vjet u mbushën sot nga bombardimet e NATO-s mbi forcat serbe. E treta e vërteta: perëndimi ndërhyri ushtarakisht kundër Jugosllavisë së Tretë e cila ishte bërë tërësisht e Millosheviqit. Janë tri arsye kryesore pse NATO hyri në luftë para dy dekadash: 1. Sepse presidenti i Jugosllavisë, Slobodan Millosheviq, nuk pranoi ta nënshkruante dokumentin e Rambujesë (ndonëse ai ishte mjaft i favorshëm për Serbinë). Kjo ishte në kontrast me marrëveshjen e Daytonit e cila e kishte fuqizuar Millosheviqin brenda (si pushtet) e jashtë (si personalitet). 2. Që Kosova të mos bëhej Bosnje. Me Srebrenicën në mendje dhe Reçakun para syve, nuk mund të lejohej përsëritja e gjenocidit në Evropë duke qëndruar duarkryq aleanca më e fuqishme në historinë e njerëzimit. Edhe kredibiliteti global i NATO-s dhe perëndimit ishin në pyetje. 3. Që Maqedonia të mos bëhej Kosovë. Vazhdimi i luftimeve midis UÇK-së dhe forcave serbe nuk do të mund të mbahej për shumë gjatë i lokalizuar në Kosovë. Shqiptarët ishin nën sulm mizor dhe përfshirja e Maqedonisë në luftë e bënte kalimin nga rreziku lokal në paparashikueshmëri rajonale (më së paku). Dita e parë dhe e fundit e këtij intervenimi 78 ditor ishin më të mirat. Sepse u godit Serbia dhe sepse u dorëzua ajo. Midis këtyre dy çasteve kemi mesatarisht nga 5 masakra në ditë kundër shqiptarëve anembanë Kosovës. Në këtë pranverë populli i Kosovës do të përkujojë mijëra 20 vjetorë, të dhembjes e pikëllimit për humbjet e vuajtjet, të krenarisë e shpresës për vendosmërinë dhe ardhmërinë".

POPUJT QË E RUAJNË TË KALUARËN JANË MË TË PËRGATITUR PËR TË ARDHMEN

"Pa të parën dhe sakrificën e shqiptarëve kudo në botë, e dyta nuk do të kishte ndërhyrë në luftën për çlirimin e Kosovës më 24 mars 1999.

Nuk ka popull dhe as shtet, asnjëherë në histori dhe askund në botë, që çlirohet veç vetë. Prandaj, çdo 24 mars duhet të ngritemi në këmbë në nderim të gjakut të mijëra shqiptarëve të rënë dhe në mirënjohje të ndihmës dhe veprimeve të drejta të NATO-s.

Popujt që e ruajnë të vërtetën e plotë të së kaluarës janë më të përgatitur për të ardhmen", ka shkruar një status në Facebook, veprimtari Uk Lushi.

"MË DHIMBESH QË SJE KËTU..."

"Para 20 vitesh ne datën e sotme më thirrë nga telefoni satelitorë dhe me gëzim të pa përmbajtur në zë më the, "Unë po e shoh lirinë dhe po ta uroj që nga tani, tash edhe me vdekë s'më mbetet peng asgjë ngaqë po e ndjej zërin e lirisë. Më dhimbesh që sje këtu ta shohësh qiellin e përflakur dhe të kuptosh sa ngjyra të bukura ka liria!!! E di që të mbeti peng ta vëje në telajo atë ndjenjë, dhe nga dashuria e madhe e pikturove me gjakun tënd pikturën e përjetsisë, atë që do të mbetet unike ndër breza. Ti e pa dhe jeton me lirinë në përjetësinë tënde, e ne të gjallët e kërkujmë ende pa e njohur dhe shijuar me të gjitha ngjyrat dhe format e saja!!!", ka shkruar një status në Facebook, Shukrije Ramadani, bashkëshorte e heroit Agim Ramadani.

Në fushata zgjedhore ndodhë që të jepen premtime jashtë ingerencave që mund të ketë presidenti i shtetit. Habit fakti kur këto premtime jepen nga profesor universitar që mirë e dinë se premtimet e dhëna para qytetarëve nuk mund t'i realizojnë nëse marrin postin e presidentit të shtetit

PREMTIMET E KANDIDATËVE PËR PRESIDENT

FONTANË DËSHIRASH!

didatja për president e VMRO-DPMNE-së Siljanovska në takimet me qytetarët ka premtuar se nëse bëhet president e shtetit prioritet do të ketë anulimin e Marrëveshjes së Prespës dhe se do të kthen emrin Republika e Maqedonisë dhe se në asnjë mënyrë nuk do të pranon të jetë presidente e Republikës së Maqedonisë së Veriut, do të ndërpres emigrimin e qytetarëve sidomos ikjen e të rinjve jashtë vendit. Ndërkaq kundërshtari i Siljanovskës, Stevo Pendarovski nga LSDM-ja kandidatë i përbashkët i 31 partive përfshirë dhe partinë shqiptare në pushtet BDI-në vazhdimisht ka premtuar se do të angazhohet për një shoqëri për të gjithë, përmirësimin e situatës ekonomike në vend si rezultat i arritjes së Marrëveshjes së Prespës, më Greqinë se nuk do ta pengon Maqedoninë të jetë pjesë e NATO-së dhe se Maqedonia e Veriut mund t'i çel negociatat me BE-në për anëtarësim të plotë në familjen Evropiane. Gjithashtu

Pendarovski si kandidat konsensual i partive në pushtet në takimet me qytetarët vazhdimin ka kritikuar partinë opozitare se 11 vite sa ka qenë në pushtet VMRO-DPMNE në masë të madhe ka shkatërruar procesin arsimor gjatë kohës së gruevizmit.

Ndryshe, kandidati i tretë Blerim Reka, si i pavarur, nuk ka zhvilluar asnjë fushatë intensive me qytetarët si dy kundërshtarët e tij por se ka respektuar ligjin dhe se me fushatë do të fillon pikërisht më 1 prill.

Nga KSHZ-ja takimet e dy kandidatëve për president shteti me qytetarët e vlerësojnë se nuk kanë bërë shkelje të ligjit sepse kanë zhvilluar fushatë partiake. "Të gjitha aktivitetet tanishme të kandidatëve për president shteti vlerëson si takime partiake e jo fushatë zgjedhore e cila zyrtarisht nis me 1 prill dhe do të zgjatë 20 ditë. Çdo aktivitet që ka të bëjë me takimet e kandidatëve për president shteti me qytetarët apo shfaqje të videove me fjalimet të

tyre me qytetarët nëpër rrjetet sociale nga data 22 mars rreptësisht ndalohen deri më 1 prill, kur edhe zyrtarisht do të fillojë fushata zgjedhore, për të përfunduar më 19 prill. Pas kësaj do të pasojë heshtje zgjedhore prej 48 orësh. Rrethi i parë zgjedhor për zgjedhjet e gjashta presidenciale do të jetë më 21 prill, ndërsa i dyti më 5 maj. Rreth të dytë do të kemi nëse 2 nga tre kandidatët për president fitojnë shumicën e nevojshme të votave", thotë Oliver Derkoski kryetari i KSHZ-ë. Sipas analistëve politik premtimet e këtitilla të kandidatëve për president janë jashtë ingerencave që ka presidenti me qëllim të manipulimit dhe përvetësimin të numrit sa më të madh të votuesve. Prandaj sipas tyre është më se domosdoshme të ndryshohet modeli zgjedhor për presidentin e shtetit dhe të zgjidhet në Parlamentin e Maqedonisë së Veriut.

Në fushata zgjedhore, sipas analistit politik Naser Ziberi ndodhë që të jepen premtime ja-

shtë ingerencave që mund të ketë presidenti i shtetit aq më shumë habit fakti kur këto premtime jepen nga profesor universitar që mirë e dinë se premtimet e dhëna para qytetarëve nuk mund t'i realizojnë nëse marrin postin e presidentit të shtetit. "Qëllimi është të përvetësojnë sa ma shumë vëmendjen e opinionit dhe të votuesve potencial edhe pse një pjesë e mirë e votuesve e dinë se janë premtime të kota, pa normativ apo mbështetje ligjore dhe se kemi të bëjnë me një manifestim dëshirash e jo mundësi konkrete për realizimin e premtime të dhëna", thotë Naser Ziberi, analist politik.

Sipas Ligjit ingrencat e presidentit të shtetit janë dhëna e mandatit për formim të Qeverisë, emërimin e ambasadorëve, pranimin e letrave akredituese të ambasadorëve të huaj, propozon dy anëtarë në gjykatën Kushtetuese, tre anëtar në Këshillin e sigurimit, kryen funksionin e komandantit Suprem të Armatës, falë të burgosurit, dhe disa funksione tjera që i takojnë me ligj. "Ndryshe kandidatët të cilët garojnë të marrin vendin e presidentit të shtetit premtojnë gjëra të shumta të cilat edhe nëse fitojnë postin e presidentit ligjërisht aspak nuk mund t'i realizojnë", thotë Naser Ziberi analist politik.

Koha Zejnulla VESELI

Shkup, 24 mars- Fushata zgjedhore e kandidatëve për president shteti sipas Ligjit zyrtarisht fillon me 1 prill. Mirëpo për tre kandidatët fushata e tyre ka filluar një muaj më parë menjëherë pas shpalljes së kandidatëve për president shteti. Me mbledhjen e nënshkrimeve tre kandidatët Stevo Pendarovski, Gordana Siljanovska Davkova në përjashtim të Blerim Reka si kandidat i pavarur, rregullisht gati një muaj realizuan takime me qytetarët duke dhënë deklarata në media me premtime të shumta për qytetarët. Kan-

Publicitet



ПОЧИТУВАЈ, НЕ МРАЗИ!
RESPEKTO, MOS URREI!
SAYGI GÖSTER, NEFRET ETME!
RESPECT, DON'T HATE!



Refet Abazi

Aktor

Gjuha e urrejtjes vret më shumë se armët!
Jo, gjuhës së urrejtjes!



Кампањата е иницирана и спроведена од АЗНММ | Fushata e iniciuar dhe realizuar nga AMMSHM | The campaign is initiated and implemented by APSPM


СЛОБОДЕН ПЕЧАТ. Бечер ПОРТА Канџан M LEJMI ZAMAN БЕРИСКО БЕРИСКО
Koha НЕЗАВИСЕН ДОКТОР ЗЕНИТ ШЕНЈА M МАКЕДОНИЈА

HULUMTIM: KUSHTETUTA NUK E PËRKUFIZON LIRINË E BESIMIT

Shkup, 24 mars - Shumica dërmuese prej 72 për qind konsiderojnë se Kushtetuta nuk e përkufizon lirinë e besimit, kundrejt 14 për qind të cilët kanë thënë se e përkufizon, tregon hulumtimi i Fondacionit "Konrad Adenauer, 'IPIS' dhe portali "religija.mk" për perceptimin e qytetarëve rreth rolit të institucioneve fetare dhe religjionit në ndërtimin e bashkëjetesës ndërfaqetare.

Të pyetur nëse shteti është i barabartë për të gjitha bashkësitë fetare, më shumë se 38,6 për qind janë përgjigjur "po", derisa 26,1 për qind "deri diku po", kundrejt 7,5 për qind me "jo" dhe 1,7 për qind "deri diku jo".

Pikat kryesore nga më shumë hulumtime shkencore dhe të sakta mbi qasjen metodologjike për atë si dhe çfarë besimtarët nga përkatësi të ndryshme fetare dinë dhe mendojnë për të ndryshmit nga vetja dhe për rolin e religjionit dhe shoqërisë janë publikuar në publikimin e titulluar "Maqedonia si shoqëri multikonfesionale—per-



ceotime për ndikimin midis religjionit dhe shtetit".

Sipas publikimit, një pjesë e madhe e qytetarëve janë prononcuar se janë paragjykses, gjegjësisht te qytetarët me besim ortodoks 57 për qind janë prononcuar në mënyrë pohuese, derisa te myslimanët kjo përqindje është madje 91 për qind. Te krishterët ortodoksë, 19 për qind rregullisht agjërojnë,

ndërsa 35 për qind ndonjëherë, derisa te myslimanët kjo përqindje është shumë më e lartë, gjegjësisht 84 për qind rregullisht agjërojnë dhe 10 për qind ndonjëherë.

Sipas analizës në publikim, ekziston dallim i caktuar midis perceptimeve dhe praktikimit të religjionit. Që është më e dukshme te ortodoksët, sesa te pjesëtarët e besimit islam. Kështu, rreth 80 për

qind e myslimanëve kanë relativisht njohje të mira themelore të Kurranit dhe traditave, që është me rreth 25-30 për qind të ortodoksëve dhe njohurive themelore të Biblës. Myslimanët, gjithashtu, më shumë njohuri kanë për Biblën apo pjesë të saj, krahasuar me njohjen e Kurranit dhe bazat e Islamit nga ana e besimtarëve ortodoksë, theksohet në publikim.



Garë humanitare „Run for Down“

Shkup, 24 mars - Mbi 600 qytetarë humanë dhe ekipe të kompanive sot së bashku me fëmijët me Sindrom Daun dhe familjet e tyre janë bashkëngjitur mdaj Garës humanitare „Run for Down“ që e organizoi Klubi i skermës "Eskrim".

Gara po mbahet katër vite me radhë, ndërsa mjetet e mbëedhura do të dedikohen për pajisjen e Qendrës Ditore për Persona me Sindromin Daun. Kryetarja e Klubit të ermës "Eskrim" Biljana Nikollovska-Kuzmanovska shprehu kënaqësi nga jehona e sivjetme e pjesëmarrësve. "Sivjet, në mënyrë të papritur kmi jehonë të madhe të qytetarëve tanë humanë dhe të kompanive me përgjegjësi shoqërore kur erdhën në një numër të madh t'i japin mbështetje ngajrjes", deklaroi Nikollovska-Kuzmanovska.

Qëndresa Sadriu, shqiptarja e parë, deputete e Kantonit të Cyrihut

Ndonëse ende nuk janë numëruar të gjitha votat e zgjedhjeve që janë mbajtur sot për Parlamentin e Kantonit të Cyrihut, albinfo.ch merr vesh se kandidatja më serioze në mesin e politikanëve me rrënjë shqiptare, Qëndresa Sadriu nga Partia Socialdemokrate, ka arritur kuotën e nevojshme. Pra, ajo prej sot është deputete në Parlamentin e Kantonit të Cyrihut, shkruan albinfo.ch Me këtë arritje, Qëndresa bëhet e para shqiptare në përgjithësi e zgjedhur në Parlamentin e Kantonit të Cyrihut, më të madhit dhe më të rëndësishmit në vend.

Bazuar në numërimin e votave të deritashme ajo ka grumbulluar 4320 vota.

Qëndresa Sadriu, ka kryer zbatimin (Lehre) si asistente dentale, pastaj ka mbaruar edhe maturën ndërsa ka filluar studimet për shkencat sociale në PH (Shkollën e



Lartë Pedagogjike) në Cyrih.

Në shtator të vitit që shkoi, Qëndresa ka filluar praktikën në shoqatën humanitare, "Sozialwerke Pfarrer Sieber".

Qëndresa Sadriu ka qenë pjesë e jetës politike në komunën e saj dhe më gjerë qysh si vajzë 19 vjeçe, shkruan albinfo.ch. Në vitin 2015

ajo kishte kandiduar edhe për deputete në Parlamentin Nacional të Zvicrës dhe, ndonëse nuk kishte arritur qëllimin, kishte fituar më së shumti vota në mesin e kandidatëve të tjerë shqiptarë

Në kantone tjera janë zgjedhur edhe shqiptarë të tjerë, në mesin e të cilave edhe Ylfete Fanaj në Kantonin e Lucernit, në parlamentin e të cilit ajo është shefe e Grupit Parlamentar të SP-së, shkruan albinfo.ch

Qëndresa është zgjedhur tashmë dy mandate edhe në Asamblenë e komunës Glattbrugg/Opfikon, ku, nga viti i kaluar ka edhe postin e kryesueses së asamblesë.


Qëndresa Sadriu ka qenë edhe njëra ndër kandidatet dhe asambleistet më të reja kur është zgjedhur në postin e asambleistes. Ajo vjen nga Gjilani dhe është në moshën 25 vjeçare. (albinfo.ch)

Përleshje e përgjakshme në burgun e Idrizovës

Shkup, 24 mars - Në burgun e Idrizovës ka ndodhur një incident i përgjakshëm ku janë përfshirë dy vëllezër bineq, përcjell Telegrafi Maqedoni. Sipas MPB-së, F.A

(34) ka përdorur armë të ftohtë për të therrur vëllain e tij O.A, derisa kanë qëndruar në ambulatën brenda burgut. Lëndimet trupore janë shkaktuar në stomak dhe në

krahun e djathtë. I lënduari është dërguar në klinikën "Nënë Tereza". MPB është duke punuar në zbardhjen e këtij rasti.



Shkupi dhe Athina korrigjojnë historinë

Shkup, 24 mars - Delegacionet e Maqedonisë së Veriut dhe të Greqisë kërkojnë që gjeneratat e reja të të dy vendeve dhe në rajon të edukohen në shpirtin e vlerave evropiane të solidaritetit, besimit dhe bashkëpunimit të ndërsjellë.

Nga Ministria e Punëve të Jashtme (MPJ) njoftojnë se dy delegacionet e Komitetit të përbashkët të ekspertëve për histori, arkeologji dhe çështje arsimore debatuan dhe miratuan një plan pune për arritjen e zgjidhjeve të përbashkëta të pranueshme, bazuar në parimet dhe qëllimet e UNESCO-së dhe Këshillit të Evropës për këto çështje.

Delegacionet vendosën që takimi i radhës i Komitetit të përbashkët të mbahet në Athinë më 12 dhe 13 prill, ku pritet që çështjet të ecin përpara, me qëllim të formulimit të udhëzimeve për miratimin në të ardhmen nga Këshilli për bashkëpunim në nivel të lartë.

Organizohen ligjëratat për edukim financiar

Shkup, 24 mars - Ministria e Financave ka paralajmëruar intensifikim të fushatës për edukim financiar në periudhën që vjen.

Sipas ministrit të Financave, Dragan Tevdovski, arsimiti financiar dhe njohja e kushteve financiare dhe prodhimeve paraqet parakusht për marrjen e vendimeve të duhura financiare dhe investuese. Shkollat dhe fakultetet mund të caktojnë ligjëratat duke komunikuar me Ministrinë në fjalë.

Në kudoër të Javës globale të parave, Ministria e Financave ka organizuar një sërë vizitash dhe ligjëratash në shkolla fillore dhe të mesme.

“Unë informova gjeneralin Klark për këtë. Unë i thash se jemi të gatshëm për të dal nga bunkeri. Gjenerali Benc Kredok, përgjegjës për forcat amerikane për ndërhyrje në Kosovë, ndërmori kontrollin e sigurisë dhe urdhëroi vendosjen e telave me gjemba në hyrje dhe muret e ambasadës, derisa marinsat ishin përreth ambasadës”, i përshkruan ngjarjen këto ngjarje tmerruese, ambasadori Christopher Hill në librin “Jeta në linjat e betejës të diplomacisë amerikane”

Me fillimin e bombardimeve të NATO-s në Kosovë dhe Serbi kundër caqeve të forcave ushtarake serbe, në Maqedoni po zhvilloheshin protesta masive kundër këtyre sulmeve dhe në përkrahje të Beogradit.

Këto protesta eskaluan më 25 marsin e 1999, kur turmat e organizuara të demonstruesve proverbë dhe huliganëve ndërhynë dhe dogjën ambasadën amerikane. Ish-te një ngjarje tmerruese që pushtoi gjithë mediat e vendit.

Një evokim të këtyre ngjarjeve ka bërë edhe ish-ambasadori amerikan në Maqedoni, Christopher Hill në librin e tij autobiografik një pjesë ia ka kushtuar misionit të tij si ambasador në Shkup dhe sidomos ngjarjes së djegies së ambasadës amerikane në 25 marsin e 1999.

Ja se si e përshkruan ngjarjen tmerruese, ambasadori Hill në librin “Jeta në linjat e betejës të diplomacisë amerikane”.

“Në ditën e sulmit dhe djegies së ambasadës më 25 mars 1999, nuk kishte pasur paraprakisht asnjë shenjë se po përgaditeshin protesta, përveç se një grupi të vogël të studentëve që këndonin këngën Give Peace a Chance para ambasadës dhe se ata nuk më njohën mua si ambasador derisa po parakaloja përkaj tyre në shëtitjen time të mëngjesit. Ndërkohë Shkupi ishte i mbushur nga makinat jeep të portokallta të misionit të OSBE, të

DETAJE RRËQETHËSE NGA AMBASADORI HILL

SI U DOGJ 20 VITE MË PARË AMBASADA AMERIKANE NË SHKUP



cilat ishin kthyer nga Kosova dhe se ishin koncentruar rreth hotelit Aleksandar Palace në Shkup, edhe atë në afërsi të ambasadës.

Deri në orët e pasdites grupi i vogël i studentëve janë tërhequr, ndërsa ata u zëvendësuan nga një grup më i madh që nuk ishte i interesuar për të kënduar, por për të gjuajtur vezë nga rrethojat e ambasadës. Bashkë me vezët fluturonin edhe gurë. Problemi kryesor ishte se Qeveria e Maqedonisë nuk kishte siguruar prani të shtuar policore. Autobusë me demonstrues po ndalonin dhe zbarkonin përkaj hotelit “Aleksandar Palace”, dhe kur shikonin praninë e shtuar policore, ata ktheheshin prapa dhe shkonin drejt bulevardit Ilinden në drejtim të Ambasadës.

Rreth orës 17.15, dritaret filluan të thyeshin nga fuqia e gurëve, ndërsa për mungesën e pranisë së policisë, zyrtari i sigurisë Charls Stouncifer, që ishte përgjegjës për të thirrë prani të shtuar policore, rekomandoi që të përgaditen hapësirat e sigurisë në bodrumin e ambasadës, për shkak se ishte vetëm çështje kohe hyrja e demonstruesve

në ambasadë.

Urdhërova të gjithë të punësuarit që të shkojnë në bodrum, duke siguruar dhe kontrolluar edhe personalisht të gjitha dhomat, për të mos harruar dika. Ka pasur rreth 42 veta, më shumë staf vendor. Deri në këtë kohë, porta hyrëse ishte rrëzuar dhe se turmat ishin në oborrin e ambasadës. Skena ishte tmerruese, demonstruesit po digjin makinat tona. Shikoja një demonstrues, jo shumë i ri, me një maskë në kokë, se si me gurë po godiste xhamin e makinës, derisa e theu, dhe më pas ndezi një koktej molotovi dhe e hodhi në pjesën e prapme të makinës. Unë pasi pashë këtë skenë i fundit bashkë me përkthyesin Bix Aliu hyra në bunker.

Ky bunker ishte i përbërë nga disa hapësira të mbrojtura me një derë çeliku, dhe se prej aty kishim lidhje direkte me Departamentin Amerikan të Shtetit, nga ku ata po ndiqnin situatën dhe dramën e krijuar. Ne ishim të lidhur edhe me një të punësuar të sigurisë, i cili përmes një lidhje telefonike mobile na informonte se çfarë po ndodhte jashtë, pasi që ai zyrtar ishte përzier

me grupin e demonstruesve.

Ne përmes një lidhje të tretë po kërkonim intervenimin e policisë së Maqedonisë, ndërsa në lidhjen e katërt ishin bisedimet me gjeneralin Vesli Klark, i cili me kërkesë të sekretares amerikane Medlin Olbrajt kishte përgaditur një njësi prej 75 marinsave amerikan nga baza Petrovec e Shkupit, për të ndërhyrë në rastin e nevojshëm.

Hill më tej përshkruan se si të punësuarit Philip Reeker dhe Tina Kaidanov po tentonin që të mbajnë moralin e kolegëve, të cilët ishin të shqetësuar dhe me nerva. Në bodrum, përveç të punësuarve ishte edhe Klara, njëra nga vajzat e mija, por edhe gazetarja Biljana Sekulovska, gazetare e televizionit A1 me një kameraman, të cilët kishin mbërritur në ambasadë disa orë më parë për një intervistë.

Problemi kryesor dhe shqetësues në bunker ishte mungesa e ajrit dhe se çfarë mund të ndodhte nëse do të digjej tërë objekti që ishte mbi ta. Në rast të djegies së hapësirës mbi ta dhe do të ngeleshin pa ajër, ata do të mund të shfrytëzonin një tunel që i çonte drejt parkin-

gut, pikërisht në vendin ku po digjeshin makinat e tyre nga demonstruesit.

Shqetësimi më i madh ishte rreth orës 18, kur demonstruesit kishin shkullur një shtyllë dhe se e përdornin atë për të hapur derën e përparme hyrëse e njohur si ‘mesjetarja’. Por 15 minuta më pas zyrtari nga jashtë ka informuar se policia ka ndërhyrë dhe se po i ndiqte demonstruesit nga oborri i ambasadës.

Unë informova gjeneralin Klark për këtë. Ai më tregoi se edhe njësi-ti i tij për intervenim të shpejtë, ishte afër ambasadës, dhe se kanë informacione se policia kishte hyrë. Unë i thash se jemi të gatshëm për të dal nga bunkeri. Gjenerali Benc Kredok, përgjegjës për forcat amerikane për ndërhyrje në Kosovë, ndërmori kontrollin e sigurisë dhe urdhëroi vendosjen e telave me gjemba në hyrje dhe muret e ambasadës, derisa marinsat ishin përreth ambasadës.

Pas kësaj pyeta njërin nga marinsat se cilat janë urdhërat e tyre dhe se ai më ktheu se në rast se disa demonstrues do të ndërhyjnë, ne do ti arrestojmë dhe do t’ua dorëzojmë autoriteteve vendore, por në rast se ndodhë ndonjë grup më i madh, atëherë do të pasojnë të shtëna paralajmëruese në ajër, por nëse edhe kjo nuk respektohet atëherë më ktheu se “nuk do të donim që ata të bënin atë”.

Departamenti Amerikan i Shtetit vendosi që ambasada të mbetet e hapur, ashtu si ambasadat e tjera, që përballeshin me demonstrata për shkak të sulmeve ndaj Jugosllavisë. Detyra jonë ishte që të shlyhen grafitet rreth mureve të ambasadës, të ngritej flamuri i ri amerikan dhe të përcillet porosia se SHBA mbetet e pranishme në Maqedoni.

MË TEPËR KUJDES ME GJUHËN

Shkup, 24 mars - Për gabimet drejtshkrimore nëpër tabela, gjuhtarët rekomandojnë më tepër kujdes dhe të respektohet drejtshkrimi në mbishkrime

Pas miratimit të ligjit për shqipen, implementimi i tij nëpër tabelat e institucioneve do të jetë sfida e radhës për kompetentët. Për gabimet drejtshkrimore nëpër tabela, gjuhtarët rekomandojnë më tepër kujdes dhe të respektohet drejtshkrimi në mbishkrime, madje kërkojnë që në këto institucione të punojnë kuadro të mirfil-

lta, dhe profesionistë të fushës.

“Gabimet gjuhësore janë të mundshme por duhet pasur kujdes për arsye se çdo tekst qoftë në mjetet e informimit, qoftë në librat shkollor dhe kudo tjetër duhet me të drejtë ti përkushtohet ose ti nënstrohet redaktimit gjuhësor ose të lekturohet mire. Ne kemi pordhuar kuadro dhe mendojs se ata të cilët e ndjejne veten se mund të jenë lectorë të mire, le të urdhërojnë” – u shpreh gjuhëtari, Ismet Osmani.

Nënkrjetari i grupit të punës

ndër resore për përdorimin e gjuhëve, Tahir Hani, për TVM2 theksoi se vendosja e tabelave pritë të përfundojë në afat prej 4 muajve, dhe në rast të mos rrespektimit të saj, inspektorati do të shqiptojë dënime për ata që shkelin ligjin.

Ai shtoi se menjëherë pas përfundimit të zgjedhjeve presidenciale, do të fillojë me punë edhe Agjencia e sapo formuar për zbatimin e gjuhëve.

Paralelisht me implementimin e gjuhës shqipe, institucionet po



bëjnë aktivitete edhe për përbushjen e detyrimeve që dalin nga marrëveshja e Prespës, zëvendë-

simin e emrit Republika e Maqedonisë me emrin e ri të shtetit, Republika e Maqedonisë së Veriut.

SFIDAT E FËMIJËVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA

SHËNDETËSIA PA KUSHTE CILËSORE

Defektologët thonë se fëmijët me SD dhe ne përgjithësi fëmijët me nevoja të veçanta kanë shumë vështirësi në jetën e tyre, në zhvillimin social, motorik, psikomotorik, emocional dhe intelektual, shkak se nuk u ofrohen shumë kushte, në vendin tonë, për zhvillim të mirëfilltë

Koha Delvina KËRLUKU

Shkup, 24 mars - Të jesh me sindromën Down në Maqedoni është një sfidë më vete, më shumë për shkak të infrastrukturës dhe barrierave sociale me të cilat haset kjo kategori e njerëzve, sesa për shkak të vetë sfidave që sjell sindromi në zhvillimin e individit. Prindërit, të cilët kanë fëmijë të këtu kërkohet që institucionet arsimore dhe shëndetësore, të krijojnë një sistem me kushte më të mira, për trajtimin dhe shkollimin e këtyre fëmijëve. Në shkollat e vendit, ka mungesë të dukshme të stafit adekuat profesional, ndërsa në shëndetësi shërbimet nuk janë cilësore.

"Në kushtet tona, të kesh një fëmijë me nevoja të veçanta, sidomos me sindromin Down, është tejmas e vështirë. Fëmija im, fatmirësisht mëson në kryeqytet, në shkollë speciale, ku shumë prej prindërve, në qytetet e tjera të vendit u mungon një shkollë e këtu. Kushtet nuk janë plotësisht të mira, në institucionin arsimor special, sepse mungon logopedi dhe për shkak se ka mbetur mbrapa në të folurën, jemi detyruar që të mësojmë me logoped që punon privatisht dhe siç vërehet është përmirësuar shqiptimi i fjalëve", thotë nëna e një fëmije me sindromin Down (A. Imeri). Logopedët, të cilët trajtojnë këta fëmijë thonë se personat me SD jetojnë në kushte mjaft të vështira për shkak se ende ato diskriminohen, nuk avancohen, nuk kycen nëpër asnjë lloj institucioni. "Ato janë të përfshirë nëpër shkolla normale megjithatë ato nuk e zhvillojnë as të folurit as inteligjencën, për shkak se për këta fëmijë duhet shkolla speciale ku një mësues apo edukator merret vetëm me trajtim individual, dhe se duhet ti përkushtohet ma tepër.




Çdo qytet ka nevojë, për klasa ose shkolla speciale, për këtë kategori fëmijësh që t'ju mundësojnë kushte sa më të mira shkollore që ata të aftësohen sa më shumë. Për momentin nuk kemi qendra adekuate, shkolla speciale në shumë qytete të vendit, personat me SD nuk punësohen askund pas shkollës, pra nuk i kemi në asnjë institucion, dhe ato mbesin në shtëpi të pa inkuadruar në shoqërinë tonë", tha logopedi Muharrem Smaili.

Nga ana tjetër defektologët thonë se fëmijët me SD dhe ne përgjithësi fëmijët me nevoja të veçanta kanë shumë vështirësi në jetën e tyre, në zhvillimin social, motorik, psikomotorik, emocional dhe intelektual, shkak se nuk u ofrohen shumë kushte, në vendin tonë, për zhvillim të mirëfilltë në çdo fushë të përparimit dhe rritjes. "Arsimi inkluziv është pa kushte në vendin tonë. Ka vetëm 1 defektolog në 3 shkolla dhe në asnjë shkollë

nuk ka logopedë. Në shkollat e rregullta, fëmijët me nevoja të veçanta, janë në kushte të mjerueshme. Për inkluzion të mirëfilltë duhet të formohet ekip vlerësimi për fëmijët e inkuadruar nëpër shkollat e rregullta, që regjistrohet në klasë të parë. Duhet fëmijët me inteligjencë shumë të ulët të klasifikohen diagnozat me çrregullimet sepse ata fëmijë munden edhe ta çrregullojnë procesin edukativ dhe arsimor. Ky ekip (psikolog, defektolog, pedagog, puntorë social) duhet të jetë mirë i trajnuar nga Byroja për zhvillim arsimor", tha Shpresa Rashiti, defektologe në shkollën speciale "Idnina" (Ardhmëria) dhe drejtuese e shoqatës "Bota ime". Prandaj nëse ka numër të atyre fëmijëve dhe diagnozave duhen të hapen paralele të veçanta, nënvizon Rashiti, ku perpos edukimit arsimor, shprehive kulturore dhe higjienike bëhet edhe rehabilitimi apo tret-

mani sipas metodave të mirëfillta nga defektologu, ose të hapen shkolla të veçanta si çështje shkollare e "Idnina". "Planprogramet e Kembrixhit, të cilat janë programe për fëmijë super inteligjentë, në shkollat e rregullta, tek fëmijët me ngecje në zhvillim dhe fëmijët me zhvillim tipik kanë vështirësi të mëdha. Edhe lidhshmëria mes njësive mësimore dhe njohurive të reja është aq keq e strukturuar dhe e organizuar. Prandaj, ne si defektologë mendojmë që ky inkluzion arsimor me këto kushte kurrë nuk do të jetë i suksesshëm pa kushte dhe kuadro profesionale, të cilët në mënyre direkte do të jenë aty ku duhet tu jepet ndihma e nxënësve", tha defektologja Rashiti. Ajo shton se në shkolla të veçanta merren njohuri për jetë të pavaruar, ndërsa ka hasur raste plot të takojë fëmijë me nevoja të veçanta nga shkollat e rregullta, por që nuk dinë të lexojnë, nuk dinë



Shpresa RASHITI

'Në shkollat e rregullta, fëmijët me nevoja të veçanta, janë në kushte të mjerueshme. Për inkluzion të mirëfilltë duhet të formohet ekip vlerësimi për fëmijët e inkuadruar nëpër shkollat e rregullta, që regjistrohet në klasë të parë. Duhet fëmijët me inteligjencë shumë të ulët të klasifikohen diagnozat me çrregullimet sepse ata fëmijë munden edhe ta çrregullojnë procesin edukativ dhe arsimor. Ky ekip (psikolog, defektolog, pedagog, puntorë social) duhet të jetë mirë i trajnuar nga Byroja për zhvillim arsimor', tha Shpresa Rashiti, defektologe në shkollën speciale "Idnina"

mbledhjen dhe zbritjen e thjeshtë. Prandaj, gjërat duhet të bëhen në mënyrë sistematike që nga klasa e parë, të vlerësohet fëmija dhe pastaj të dërgohet në shkollim adekuat, thotë Rashiti.

Kryetarja e klubit "Eskrim", Biliana Kuzmanovska, thotë se realizojnë aktivitete humanitare, si „Run for Down“ (gara për vrapim, për ndërgjegjësimin dhe ndihmë të njerëzve me SD) dhe se sporti për këta fëmijë është jashtëzakonisht i shëndetshëm. Mirëpo, ka hasur vështirësi për inkuadrimin e këtyre personave në gara të ndryshme, por në tre vitet e fundit kanë shtri dorën disa kompani që zhvillojnë gara humanitare.

Ndryshe, personat e prekur nga kjo sindromë hasin vonesë si në zhvillim mendor edhe fizik, por nuk duhet përjashtuar faktin që me mbështetjen e terapeve në fëmijërinë e hershme të tyre, këta persona mund të vazhdojnë t'i përmbushin potencialet e tyre jetësore të jetojnë në mënyrë të pavarur, jeta e tyre nuk është e kufizuar nga asgjë thjesht kanë nevojë për mbështetje dhe ndihmë tonë. Tiparet e tyre fizike nuk janë pengesë për t'u futur në shoqëri dhe për të qenë të veshëm për komunitetin ata vetëm duan që t'i pranojnë ashtu siç janë. Edhe pse thuhet se personat me SD kanë të njëjtën paraqitje këta persona më tepër ngjasojnë me të afërmit e tyre se sa me personat të cilët ndajnë po të njëjtin çrregullim.

NDËRTIMI I DIGAVE, QEVERIA PRET TË SIGUROHEN MJETET

Zëvendëskryeministri për çështje ekonomike, Koço Angjushev ka thënë se ka njohuri për këtë problem, respektivisht për digat mbrojtëse në lumin e fshatit Poroj. Ai më tej ka thënë se një pjesë e mjeteve janë siguruar, por pret që të sigurohen të gjitha mjetet.

PAS ZAELIT, EDHE

ANGJUSHEV ME PREMTIME

Koha

Urim HASIPI

Tetovë, 24 mars - Vazhdojnë në pafundësi premtimet për banorët e fshatit Xhermë dhe Poroj se problemi me ndërtimin e digave do të zgjidhet. Nëse në vizitën e vitit 2017 ishte kryeministri Zoran Zaev që premtoi zgjidhje të këtij problemi, kësaj radhe ka qenë zëvendësi i tij, Koço Angjushev që ka dhënë sërish premtime, duke sqaruar se për problemin në fjalë tashmë është diskutuar me kryetarët e komunave të Pollogut në Ministrinë e Transportit. "Në ne qeveri punojmë në maksimum që ky rajon të mbrohet nga vërshimet. Në këtë drejtim, në Ministrinë e Transportit dhe Lidhjeve mbajmë një mbledhje me kryetarët e komunave të Pollo-

gut, ku isha i pranishëm edhe unë, por edhe institucione tjera që kanë të bëjnë me atë problem. U pajtuam për të bërë analiza dhe se çfarë projektesh kemi, pra bëhet fjalë për programe nga donatorë të huaj. Të gjithë këtë, ne e kemi parasysh dhe do ta parashikojmë në buxhet, nëse kemi rishikim të buxhetit, do të parashohim mjete për këtë vit, por nëse nuk ka rishikim, atëherë në buxhetin e vitit të ardhshëm do të ketë mjete, që të ndihmojmë maksimalisht komunat që të marrin mjete për të filluar me sanimet", deklaroi Angjushev. Ai më tej ka thënë se një pjesë e mjeteve janë siguruar por pret që të sigurohen të gjitha mjetet. Angjushev ka thënë se ka njohuri për këtë problem, re-

spektivisht për digat mbrojtëse në lumin e fshatit Poroj. "Për një pjesë janë siguruar paratë, por ta shohim sa është vlëra e përgjithshme e mjeteve, që të mund ajo të zgjidhet. Konkretisht për problemin në Poroj dhe Xhermë, të cilin e di personalisht, ekziston një studim nga më herët, ku janë dëmtuar digat dhe problemi është serioz. Mendoj se punët janë në rrugë të mirë dhe mendoj se do të sigurohen mjete dhe do të zgjidhet problemi" tha Angjushev. Nga ana tjetër, kryetarja e Komunës së Tetovës, Teuta Arifi në një prononcim të saj për mediat ishte shprehur se duhet që të realizohet plani i UNDP-së për vendosjen e pendave dhe të rregullohet shtrati i Lumit, që të mos ketë vërshime si ato të

kaluarat, ku kishte shumë dëme por edhe sot e kësaj dite në këtë drejtim nuk ka asnjë lëvizje pozitive. Banorët e fshatit Poroj kohë më parë edhe përmes protestave kanë kërkuar nga të gjitha institucionet që të merren më seriozisht me rregullimin e digave përgjatë lumit, por deri më tash nuk ka asnjë lëvizje pozitive. Sipas banorëve, në të kaluarën institucionet janë marrë vetëm me eliminimin e pasojave, gjegjësisht pastrimin e mbetjeve përgjatë lumit dhe hapjen e rrugës, por jo edhe me rregullimin e shtratit. Kërkesa e tyre është që institucionet të mbajnë premtimin dhe të koncentrohen me rregullimin e digave tek vendi i quajtur "Uji i Shpejtë", në burimin e lumit në fshatin Gjermë.

Bie kultivimi i mjaltit

Shkup, 24 mars - Kultivuesit e bletëve nga i gjithë vendi janë mbledhur në sheshin e Shkupit, për të promovuar shumëllojshmëritë e mjaltit. Ky Panair i Bletarisë organizohet pas 30 vjetësh. Gjatë kësaj fundjave, qytetarët mund të shijojnë mjaltin e cilësisë së lartë, për të cilën bletarët thonë se shpenzojnë shumë e fitojnë pak.

Zëvendësimi i sheqerit të bardhë definitivisht është mjalti për shkak se është i shëndetshëm, i rigjeneron qelizat e trupit dhe ndikon pozitivisht në organizmin e njeriut. Madje duke e stabilizuar qarkullimin e gjakut dhe ritmin e zemrës - tha Marina Mitrevska, Bletare.

Nga Federata e Bletarëve thonë se në të kaluarën një familje e bletarisë ka kultivuar mesatarisht dhjetëra kilogram mjaltë në muaj, kurse tani mezi arrijnë të prodhojnë dy kilogram.

Për të arritur një prodhim cilësor duhet të investohet mund dhe para, por sa fitojmë gjithmonë është në pikëpyetje, sepse kemi edhe ndryshimet klimatike. Para disa vitesh kultivimi bletarisë ishte i keq në vendin tonë, por vitin e kaluar ishte diçka më mirë. Do të




thoja në Maqedoni ende ka mungesë të mjaltit, për këtë arsye importojnë nga jashtë, por duhet të konsumohen produktet vendore - deklaroi Jane Markov, Kryetar i Federatës së bletarëve.

Kjo turiste nga Roma, thotë se në Shkup është në ditën e qëlluar pasi që është adhurues e mjaltit. Mund të shijosh mjaltin, me një shije ndryshe që nuk e kam shijuar më parë, kështu që është për bukur. Është një

përvojë e re. Kam qenë këtu dy-tri herë sepse babai im punon këtu - thotë Allegra Morelli, Turiste nga Italia.

Organizatorët e Panairit të Bletarisë thonë se bletaria është shndërruar në biznes familjar, duke u subvencionuar edhe nga programet IPARD për zhvillim rural, por nuk kanë të dhëna nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë sesa është sasia e prodhuar vjetore nga kultivuesit vendorë.



Gjimnazi i Tetovës nikoqir i garave nga filozofia

Tetovë, 24 mars - Gjimnazi "Kiril Pejçinoviç" në Tetovë ka qenë nikoqir i organizimit të garave rajonale nga lënda e filozofisë ku kanë marrë pjesë rreth 29 nxënës të qyteteve të ndryshme të Maqedonisë së Veriut. Sipas koordinatorit të ktyre garave profesor Sheval Latifit nxënësit të cilët fitojnë pikët maksimale në këtë testim e fitojnë të drejtën për të garuar në garat republikane. Ahmed Qazimi nga Sektori për veprimtari publike pranë komunës së Tetovës nënvizoi se me organizimin e garave në lëndë të ndryshme në shkollat e qytetit të Tetovës synohet që Tetovën ta shndërrojmë në një qendër ku organizohen aktivitete të ndryshme me karakter shkencor dhe arsimor siç janë edhe garat. Përndryshe gara rajonale nga lënda e filozofisë paralelisht me garat në gjimnazin "Kiril Pejçinoviç" në Tetovë janë mbajtur edhe në Shkup dhe Veles ndërsa rreth 40 nxënës nga këto gara do të marrin pjesë në garat në nivel republikan, ndërsa në Tetovë sot janë mbajtur gara edhe nga lënda e biologjisë dhe gjuhës angleze.

Drejtoria për Mbrojtje e gatshme kundër fatkeqësive

Tetovë, 24 mars - Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim Njësia Rajonale në Tetovë në përputhje me vlerësimin e rrezikshmërisë nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësive tjera si dhe Planin për Mbrojtje dhe shpëtim që mbulon vetëqeverisjet lokale, Tetovë, Bërvenicë, Bogovinë, Zhelinë, Tearcë dhe Jegunovcë është në gadishmëri të plotë për tu mbrojtur nga fatkeqësitë natyrore, ndihmë dhe mbështetje për të ndërmarë veprime të caktuara si dhe masa mbrojtëse urbane-tekniqe e humanitare. "Njësia rajonale për Mbrojtje dhe shpëtim Tetovë posedon Shtab për Mbrojtje dhe shpëtim, forca shtetërore për mbrojtje dhe shpëtim dhe ekupe për reagim të shpejtë gjatë fatkeqësive natyrore, që angazhohen me vendim nga ana e drejtorit të drejtorisë për mbrojtje dhe shpëtim. Çdo njësi e qeverisjes vendore është e obliguar që t, i respektojë procedurat për angazhimin e shtabit vendor dhe forcave për mbrojtje dhe shpëtim. Nëse komunat nuk janë në gjendje të përballen me ndonjë fatkeqësi natyrore apo fatkeqësive të shkaktuara është e nevojshme që deri te Njësia Rajonale për Mbrojtje dhe shpëtim -Tetovë të dorëzojnë kërkesë me shkrim për angazhimin e forcave tona për mbrojtje dhe shpëtim të formuara pranë Njësies rajonale për Mbrojtje dhe shpëtim-Tetovë, thuhet në apelin e kësaj drejtorie.

KËMBIMI TREGTAR I MAQEDONISË SË VERIUT

GJYSMA E EKSPORTIT NGA INVESTITORËT E HUAJ

Një pjesë e madhe e prodhimeve që Maqedonia eksporton jashtë janë lëndë të para ose gjysmë prodhime që në ndonjë shtet tjetër inkorporohen në prodhime të gatshme. Gjithashtu më shumë se gjysma e eksportit realizohet nga kompanitë e huaja që shumë pak shfrytëzojnë lëndët e para vendore

Koha Fisnik Pasholli

Shkup, 24 mars - Prodhimet më të eksportuara nga shteti në vitin e kaluar ishin pjesët e ndryshme të automjeteve, apo katalizatorët dhe filtrat e veturave, përçuesit, sediljet e automjeteve, autobusët...

Analiza e revistës "Kapital", tregon se gati gjysma e tërë eksportit në vend të vlefshëm në total 5 miliardë e 860 milion euro prodhohet në zonat e lira ekonomike, ndërsa 47 për qind e eksportit shkon për Gjermani, që ndërliket me prodhimin e orientuar për industrinë gjermane të automjeteve. Nga ana tjetër, analiza e të dhënave tregon se një e katërta e apo afër 1.2 miliardë euro është i vlefshëm eksporti vetëm i kompanisë së prodhimit të katalizatorëve "Xhonson Meti", që ushtron aktivitetin e saj në zonën e lirë ekonomike në Bunarxhik. Nëse kemi parasysh edhe vlerën e eksportit të filtrave për pastrim të gazrave me vlerë prej 616 milion euro dhe përçuesit për ndezje me vlerë prej 480 milion euro, atëherë mund të konstatojmë se së bashku me eksportin e katalizatorëve, gati gjysma e eksportit vendor vjen nga investitorët e huaj që punojnë për markat e njohura të veturave, në zonat e lira ekonomike.



Një rëndësi të madhe në eksport ka edhe shitja jashtë e industrisë së hekurit dhe çelikut me vlerë prej 421 milion euro, eksporti i industrisë së tekstit me 353 milion euro, eksporti i metaleve të ndryshme me vlerë prej 219 milion euro. Njëherazi eksporti i autobusëve të Van Holl në vitin e kaluar ka arritur në 175 milion euro, ndërsa i sediljeve ka arritur në 202 milion euro.

Një nga adutet e eksportit është edhe ai duhanit dhe cigareve me 128 milion euro, i industrisë farmaceutike që më së shumti ndërliket me shitjen me sukses jashtë të Alkaloidit me 88.4 milion euro, apo eksporti i pijeve me afër 66 milion euro. Eksport të rëndësishëm shikuar në shifra, realizojnë edhe akumulatorët me 75 milion euro, dhe mermeri dhe materialet ndërtimore me 73 milion euro.

FUQIZIMI I EKSPORTIT TË ËMBËLSIRAVE INDUSTRIALE

Dobësi e madhe e ekonomisë vendore vite me radhë është rritja e dobët e eksportit si të prodhimeve bujqësore ku pemë janë eksportuar në vlerë prej 40 milion euro ndërsa perime në vlerë prej 55 milion euro. Dobët qëndrojmë edhe me eksportin e ushqimit ku vitin e kaluar shënohet eksport prej 319 milion euro me një rritje modeste prej 4 për qind në raport me vitin paraprak.

Në këtë sektor, mund të jemi të

10 EKSPORTET KRYESORE

1. Katalizatorët - 1.2 miliardë euro
2. Filtrat për pastrim të gazrave - 616 milion euro
3. Përçuesit për ndezje - 480 milion euro
4. Hekur dhe çelik - 421 milion euro
5. Industria e tekstit - 353 milion euro
6. Eksporti i prodhimeve metalike - 219 milion euro
7. Sediljet - 202 milion euro.
8. Xehet metalike dhe jo metalike - 183 milion euro
9. Autobusët e Van Holl - 175 milion euro
10. Pemët dhe perimet - 146 milion euro

kënaqur me rritje dhe fuqizimin e eksportit të ëmbëlsirave industriale ku vetëm në vitin 2018 është shënuar eksport prej 60 milion euro që paraqet rritje prej 10 për qind si rrjedhojë e orientimit të një pjesë të fabrikave të ëmbëlsirave në shtet ndaj rritjes së gamës së prodhimeve dhe orientimit në eksport. Rezultate të kënaqshme shënon edhe eksporti i verës me 50 milion euro. Potencial i madh dhe i pashfrytëzuar për eksport qëndron edhe tek industria e përpunimit të pemë perimeve që në vitin 2018 ka shënuar eksport prej afër 50 milion euro. Eksporti i mishit dhe përpunimit të mishit është i vlefshëm 25 milion euro. Mundësi të mëdha për eksport ekzistojnë edhe tek shitja jashtë e mishit të qengjit prej të cilit vitin e kaluar janë fituar afër 10 milion euro.

Dobët qëndrojmë edhe me eksportin e qumështit dhe përpunimeve të qumështit që vjet kanë pasur vlerën prej 10 milion euro,

ndërsa nga ana tjetër tregu vendor është i vërsuar me qumësht dhe prodhime të qumështit nga jashtë. Në vitin 2018, kemi eksportuar qumësht dhe ajkë me vlerë prej vetëm 3.2 milion euro, jogurt me vlerë prej 2.7 milion euro dhe djathë me vlerë prej as 2 milion euro apo me vlerë prej 1.5 milion euro. Pak eksportojmë edhe vezë me afër 700 mijë euro dhe mjaltë me afër 600 mijë euro.

Në eksportin e vlefshëm 55 milion euro të perimeve, dominon lakra me 15 milion euro, domatet dhe specat me nga afër 10 milion euro, kërpudha me 4 milion euro, tranguj me 3.6 milion euro, qepë me 1.3 milion euro dhe patate me 1 milion euro.

Njëherazi eksportojmë edhe rrush me vlerë prej 13 milion euro, mollë me vlerë prej 8 milion euro, pjeshka me vlerë prej 4 milion euro, kumbulla me vlerë prej 2.4 milion euro, dhe qersh dhe bostan me nga me 1.2 milion euro.

E ARDHMJA E PRODHIMEVE INOVATIVE

Është interesant të theksohen edhe tregjet kryesore eksportuese të Maqedonisë së veriut. Me vlerë prej 2.7 miliardë euro në këtë drejtim dominon Gjermania si rrjedhojë e eksportit të pjesëve për vetura, në vendin e dytë me eksport prej 305 milion euro është Bullgaria dhe në vendin e tretë për eksport është Serbia me 235 milion euro.

Në vendin e katërt për kah vlera e mallrave që eksportohen jashtë është Kosova me 226 milion euro, e pasuar nga Belgjika me vlerë prej 219 milion euro të eksportit. Në top dhjetëshin e shteteve ku më shumë eksportojnë janë edhe Greqia me 190 milion euro, e pasuar nga Italia, Rumania, Austria dhe Hungaria.

Ndryshe në të ardhmen sfida për ekonominë e vendit, rritjen e pagave, përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve, paraqet edhe rritja e numrit të prodhimeve me vlerë të shtuar apo prodhimeve inovative në vend të numrit të vogël të prodhimeve me fazë finale të përpunimit apo që janë të dedikuara për konsum final. Një pjesë e madhe e prodhimeve që Maqedonia eksporton jashtë janë lëndë të para ose gjysmë prodhime që në ndonjë shtet tjetër inkorporohen në prodhime të gatshme. Gjithashtu më shumë se gjysma e eksportit realizohet nga kompanitë e huaja që shumë pak shfrytëzojnë lëndët e para vendore por të njëjtat i importojnë për përpunim, ndërsa bashkëpunimi i kompanive vendore dhe investitorëve të huaj që punojnë në Zonat ekonomike është aq i vogël dhe i papërfillshëm sa që mund të matet me peshoren e farmacisë. Prej afër 72 mijë kompanive në vend, vetëm 5 për qind prej tyre apo 3500 eksportojnë jashtë shtetit. Prej tyre 2800 janë mikro me deri 10 të punësuar dhe firma të vogla me 50 të punësuar, ndërsa vetëm 110 janë kompanie të mëdha me mbi 250 të punësuar.

Edhe Kosova ndalon operimin e aeroplanëve Boeing

Kosova e ka ndjekur shembullin e disa shteteve tjera duke e ndaluar qarkullimin e të gjithë aeroplanëve të tipit "Boeing 737-8 MAX" mbi hapësirën e saj ajrore për shkak të dy aksidentëve ajrore me aeroplanë të këtij modeli, ku mbetën të vdekur më shumë se 340 persona. Mbi hapësirën ajrore të Republikës së Kosovës është ndaluar edhe fluturimi i avionëve të tipit "Boeing 738-9 MAX".

"Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës, informon të gjithë qytetarët se Drejtori i Përgjigjëm i Autorite-

tit të Aviacionit Civil përkohësisht ka ndaluar të gjitha operimet e tipeve të aeroplanëve Boeing 737-8 MAX si dhe Boeing 738-9 MAX mbi hapësirën ajrore të Republikës së Kosovës, për shkak të hetimeve në vazhdim lidhur me pajisjet e mjeteve ajrore Boeing 737-8 MAX dhe Boeing 738-9 MAX", thuhet në një njoftim të AACK'së.

Ndalesa hyn në fuqi menjëherë dhe vazhdon deri në njoftimin e radhës, ka bërë të ditur AACK. Përpos Kosovës, edhe Britania e Madhe, Australia dhe Singa-

pori kanë marrë vendim të martën që të anulohen të gjitha fluturimet që janë paraparë të kryhen me aeroplanët e sipërpërmendur.

Ditë më parë një avion i Ethiopian Airlines u rrëzua duke shkaktuar vdekjen e 157 pasagjerëve në bordin e tij. Ndërkohë që hetimet janë në vijim për shkaqet që sollën tragjedinë, nga ana e autoriteteve të aviacionit në vende të ndryshme të botës është marrë masa e ndalimit për hyrjen e avionëve që i përkasin të njëjtës serie prodhimi të Boeing. (Monitor.al)



Tezja e viktimës, e cila nuk deshi të flasë para kamerës, tha se nuk ishte hera e parë që autorja e vrasjes të ketë dalë në rrugë me armë të ftohta. Sipas saj, e dyshuara 75-vjeçare kishte probleme mendore, por autoritetet në Zvicër nuk e llogarisnin rrezik për dikë

VRASJA E 7 VJEÇARIT NË BASEL, A DËSHTUAN AUTORITETET ZVICERANE?

Një grua 75 vjeçare vrau Ilias Mahmutin në Basel. Dy ditë pas ngjarjes Kosova dhe Zvicra vazhdojnë të jenë të tronditura me rastin. Por a dështuan autoritetet për të mbrojtur një nxënës?

75 vjeçarja Angela N. i mori jetën një fëmije shqiptar me babin në Zvicër. Aktualisht është urdhëruar një raport psikiatrik për të treguar përgjegjësinë e dorasës.

Mediat raportuan se pensionistja kishte borxhe mbi 100.000 franga. Përveç zisë për viktimën, pyetja që mundon të gjithë është se si mund të ndodhte një tragjedi e tillë?

Psikiatri mjeko-ligjor Josef Sachs, nuk sheh dështim të autoritetit publik bazuar në informacionet që kishte në dispozicion.

“Që një person i paqëndrueshëm mendërisht të burgoset ai duhet të cilësohet si egoist ose që nuk duron të huajt”, thotë ai.

Një masë e tillë sipas Sachs, merret nëse i dyshuari tenton vetëvrasjen, ishte i rrezikshëm për



rrethin ose kishte shfaqur dhunë të përsëritur.

“Potenciali i dikujt për dhunë në shumë raste është vështirë të parashikohet”, shtoi ai.

Eksperti për mbrojtjen e fëmijëve dhe të rriturve Christoph Häfeli, thotë se aktualisht pragu për shtrim në spitale psikiatrike është shumë i lartë. Në të kaluarën, ai thotë se i dyshuari për probleme mendore mund të strehohej shumë më lehtë edhe kundër vullnetit të tij.



“Është e mundur që ndihmësi i saj të ketë parë potencialin e dhunueses për të huajt”, thotë ai.

Sipas Häfeli, autoritetet do të duhej të verifikonin 75 vjeçaren për

këto çështje për shkak të borxheve që ajo kishte. Sipas tij një gjë e tillë do të duhej të bëhej edhe kundër vullnetit të saj.

Shumë familjarë, miq e të

afërm të viktimës, morën pjesë në varrimin e 7-vjeçarit në Gjilan. Të pikëlluar e të tronditur me rastin, familjarët e viktimës shpresojnë “në zbardhjen e rastit nga autoritetet zvicerane”.

Tezja e viktimës, e cila nuk deshi të flasë para kamerës, tha se nuk ishte hera e parë që autorja e vrasjes të ketë dalë në rrugë me armë të ftohta. Sipas saj, e dyshuara 75-vjeçare kishte probleme mendore, por autoritetet në Zvicër nuk e llogarisnin rrezik për dikë.

Nëna e viktimës nuk arriti ta thotë asnjë fjalë, derisa me lot vendosi kurora për të birin. Ndërkohë, të shtunën, në rrugët e Bazelit, për rastin e vrasjes së 7-vjeçarit, u mbajt marsh solidarizues deri te vendi i krimit në rrugën “Galler Ring”.

Iljas Mahmuti, me prejardhje nga Lipjani, u vra në mënyrë mizore, të enjten në Bazel, nga një 75-vjeçare, e cila goditi viktimën disa herë me thikë në qafë, derisa ai po kthehej nga shkolla. Fëmija ishte gjetur i gjallë nga mësuesit e shkollës, por kishte vdekur në spital nga hemorragjia. Ilias Mahmuti, 7 vjeçar u varros të shtunën në Gjilan.

Burri mbyti gruan, dyshonte se e tradhtonte

Një krim në familje ka ndodhur të premten në mbrëmje, në fshatin Grekan të Gramshit, ku Gurie Hysa, 31 vjeçe, nënë e tre fëmijëve, mbeti e vdekur.

Autori i krimit është bashkëshorti i saj, Elvin Hysa, 32 vjeç, i cili është vënë në pranga nga forcat e Policisë. 32-vjeçari dyshohet se ka mbytur gruan e tij pas një debati, që patën para se të flinin gjumë. Pasi ka pritur momentin që 31-vjeçaren e ka zënë gjumi, e ka mbytur me jastëk.

Edhe pse në shtëpi ndodhej dhe babai i autorit, ky i fundit nuk ka dëgjuar asgjë, pasi i arrestuari nuk i ka lejuar viktimës të bëjë asnjë përpjekje për të shpëtuar për shkak të forcës, por nisur dhe nga fakti se ishte në gjumë. Ndërkohë, të tre fëmijët e çiftit atë natë nuk ndodheshin në shtëpi, pasi kishin shkuar për vizitë të gjyshë të tyre në Berat. Ngjarja mësohet se ka ndodhur rreth mesnatës kur çifti, pasi kishte debatuar, është shtrirë për të fjetur. 32-vjeçari në nerva ka marrë jastëkun dhe e ka mbytur gruan e tij, nënën e tre fëmijëve. Pas këtij akti, ai ka dalë i qetë nga dhoma e gjumit dhe i ka thënë babait të tij “e mbyta Gurijen”.

I ati i tronditur ka shkuar në dhomë me mosbesim, por kur ka parë nusen të vdekur, ka lajmëruar menjëherë Policinë për atë që kishte ndodhur. Ndërkohë, 32-vjeçari ka dalë nga banesa, ka marrë kafshën e shtëpisë, një mushkë dhe gjatë



natës ka shkuar te motra e tij e martuar në fshatin Lumras në Berat. Pasi i ka treguar motrës që ka vrarë gruan, ajo e ka bindur që të vetëdorëzohet në Polici. Pas kësaj, 32-vjeçari është kthyer dhe në orët e para të mëngjesit ka arritur në banesë. Pas tij kanë mbërritur dhe forcat e Policisë së Gramshit, të cilët e kanë arrestuar në kushtet e flagrancës.

Grupi hetimor, që po punon për zbardhjen e këtij krimi në familje, ka mbledhur provat e gjetura në banesë për rindërtimin e skenës së krimit. Alvin Hysa nuk ka bërë rezistencë, por vetëm i ka kërkuar babait të tij të kujdeset për 3 fëmijët. Banorë të fshatit thonë se, 32-vjeçari njihet si person problematik dhe ushtronte vazhdimisht dhunë mbi gruan

e tij. Madje, ai për këtë gjë ishte dënua dhe dy herë me dënime të lehta. Familja Hysa jetonte në kushte të vështira ekonomike.

Banesa e tyre është e vjetër dhe tejet e amortizuar. Të vetmet të ardhura që kishte familja ishin pensioni i kryefamiljarit dhe kempit i autorit të krimit, si i paaftë për të punuar. Alvin Hysa dhe Gurie Hysa ishin të martuar prej 12 vitesh. Ata kanë sjellë në jetë tre fëmijë nga marrëdhënia e tyre, ku vajza më e madhe ishte 12 vjeçe dhe dy djem, 9 dhe 5 vjeç, shgkruna panorama. Me humbjen e nënës dhe arrestimin e babait të tyre vrasës, tashmë tre fëmijët e mitur do të mbeten në kujdesin e babait të autorit, 62-vjeçarit Asqeri Hysa.

Mori 51 nxënës peng dhe i vuri zjarrin autobusit

Një 47-vjeçar nga Senegali ka rrëmbyer 51 gjimnazistë në Itali, si formë për t'u hakmarrë për emigrantët që mbetën viktimë në Mesdhe. “Kisha planifikuar një atentat terrorist për t'u hakmarrë ndaj emigrantëve të mbetur viktimë në Mesdhe dhe ndaj ministrit të brendshëm Matteo Salvini e aleatit të tij qeverisës Luigi Di Maio”, ka thënë Ouesseynou para prokurorit italian.

Një ditë më parë, 47-vjeçari Ouesseynou Sy, me origjinë nga Senegali por me shtetësi italiane mori peng autobusin me 51 fëmijë të një shkolle në komunën e Cremës në provincën e Cremonës. Kanë qenë 41 minuta dramatike për 51 fëmijët që së bashku me dy mësuese janë sekuestruar nga shoferi i autobusit të shkollës së tyre, i cili i kërcënon se do t'u vinte zjarrin pasi i kishte spërkatur të gjithë me benzinë.

Më pas kishte detyruar mësuesit t'i lidhnin duart e disa nxënësve duke i sekuestruar telefonat celularë.

Ka qenë 13 vjeçari Ramy, djalë i një familje emigrante nga Maroku, ai që fshehu telefonin e tij celular dhe lajmëroi të atin.

Një aksion policor spektakolar shpëtimi ndërsa autobusi ishte përfshirë nga flakët, ka çuar në shpëtimin e 51 fëmijëve së bashku me mësuesit e tyre.

Gjatë marrjes në pyetje nga antiterrorizmi italian, Ouesseynou Sy ka pranuar qëllimin terrorist të aktit të tij kundër politikave të emigracionit të qeverisë italiane.

47 vjeçari Ouesseynou Sy rezultoi të jetë arrestuar më parë nga policia italiane me akuzën e drejtimit të automjetit në gjendje të dehur.

PROCESET POZITIVE NUK MUND TË NDODHNIN PA NATO-n



Nga
Dr. Skender ASANI



Fati i kombit tonë ka kaluar nëpër ngjarje të vullshme historike, shpeshherë i shkelur dhe i nëpërkëmbur nga armiqet e lirisë dhe demokracisë!

Ne, para se vijmë te 24 marsi i vitit 1999, ia vlen të kujtojmë edhe disa ngjarje kryesore në retrospektivë, të cilat lanë gjurmë të pashlyeshme në historinë tonë.

Në shekullin e XIX lindën projekte të mëdha hegjemoniste në Ballkan, të cilat u zyrtarizuan në konferencat e Londrës e Versajës, dhe u eliminuan pikërisht në 24 marsin e vitit 1999.

Në dekadat e para të shekullit XIX, Serbia, Greqia, e më vonë edhe Bullgaria, e fituan pavarësinë e tyre, dhe menjëherë shprehën tendencat ekspansioniste nëpërmjet projekteve famëkeqe, siç ishin: Serbia e Madhe, Greqia e Madhe, Bullgaria e Madhe. Rusia ishte tutorja kryesore e këtyre nxitjeve, në kurriz të popujve më të vegjël.

Projekti rus u realizua me Aleancën Ballkanike. Me betejën e Kumanovës të tetorit 1912, iu dha goditja përfundimtare Perandorisë Osmane, dhe me këtë rast u krijuan Serbia e Madhe dhe Greqia e Madhe. Konferenca e Ambasadorëve në Londër i vërtetoi gjendjet faktike në teren, ndërsa Evropa në atë kohë nuk ishte e gatshme për një luftë botërore gjithë përfshirëse. Në Konferencën e Londrës, me insistimin e Austro-Hungarisë, u krijua shteti shqiptar i gjymtuar.

Në Konferencën e Versajës dominuan dy koncepte kryesore: njëri koncept ishte ai koalicionit të Antantës, të cilët ishin fitues e Luftës së Parë Botërore, dhe kërkonin territore nga shkatërrimi i Perandorisë Osmane dhe asaj Austro-Hungareze. Ndërsa, koncepti i dytë ishte ai i presidentit amerikan Vudro Vilson, i cili i prok-

lamoi 14 kërkesat e njohura, që u mundësonin edhe popujve të vegjël të drejtën për vetëvendosje. Nga ky koncept i presidentit amerikan, si garancë që të fitohet kjo e drejtë, gjatë procesit u themelua Shoqata e Kombeve në Gjenevë, dhe më vonë Organizata e Kombeve të Bashkuara në Nju Jork. Më vonë, gjatë akteve të shtetndërtimit, shumë shtete u bazuan në konceptin e Vilsonit, me çka këtë të drejtë e fitoi Shqipëria, Maqedonia, dhe në dekadën e parë të shekullit XXI, edhe Kosova.

Gjatë intervenimit të Aleancës Veriatlantike-NATO, kundër Serbisë,

në vitin 1999, si argument kryesor u morë kriza humanitare, por në esencë, në mënyrë të natyrshme ishte vazhdimësia e konceptit të presidentit Vilson për vetëvendosje të popujve të vegjël. Kjo për faktin se nga projekti i shekullit XIX, që e realizonte Serbia, e kishte ngulfatur vullnetin e popujve tjerë të Ballkanit që ta ushtronjë këtë të drejtë të natyrshme. Dhe, vetëm pas intervenimit të NATO-s dhe kapitullimit të Serbisë, popujt ballkanik filluan të frymojnë lirshëm dhe të krijojnë shtetet e tyre të pavarura.

Mali i Zi e fitoi pavarësinë e plotë

Sot kur e kujtojmë këtë datë të rëndësishme për ardhmërinë tonë, kujtojmë edhe kontributin dhe sakrificën e mijëra veprimtarëve, luftëtarëve, dëshmorëve e martirëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të cilët me rezistencën e tyre aktive, e nxitën 24 marsin dhe të gjitha ndryshmet pozitive që ndodhën në këto treva



dhe u anëtarësua në NATO; Kroacia u anëtarësua në NATO dhe BE; Shqipëria u anëtarësua në NATO; Kosova shpalli shtetin e pavarur, me perspektivë të qartë drejt NATO-s dhe BE-së; Republika e Maqedonisë, tanimë e Veriut, me ndryshimet e fundit kushtetuese, përfundimisht po bëhet gati të jetë anëtarja e re e NATO-s. Me këtë rreshtim të qartë të shteteve ballkanike në krahun e Aleancës më të madhe ushtarake-politike perëndimore, po krijohet një klimë e re e perspektivës tonë të përbashkët evropiane. Të gjitha këto procese pozitive të kohës më të re në Ballkan, zor se do të mund të ndodhnin, pa intervenimin e sigurt dhe energjik të NATO-s, 20 vjet më parë, me në krye Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Por, sot kur e kujtojmë këtë datë të rëndësishme për ardhmërinë tonë, kujtojmë edhe kontributin dhe sakrificën e mijëra veprimtarëve, luftëtarëve, dëshmorëve e martirëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të cilët me rezistencën e tyre aktive, e nxitën 24 marsin dhe të gjitha ndryshmet pozitive që ndodhën në këto treva.

Ju faleminderit shumë!

(Fjalim me rastin e shënimit të 20 vjetorit të fushatës ajrore të NATO-s kundër caqeve militariste serbe)

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovashja lok.14 - përdhësë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribuimi: "Sloboda Pecal" - rr. Kej 13 Noemvri nr.3/1-238, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e diel, 24 mars 2019 | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006

Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA

E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribuim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221

Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhirollogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

MINISTRIA E PUNËVE TË KOTA



Nga
Xhafer Shatri

Ka pesë vjet e këtej që aktiviteti diplomatik i Kosovës ka marrë një teposhtëze të paimagjinueshme. Janë rralluar njohjet deri në ndërprerje dhe ka filluar një proces i panjohur ndonjëherë (qoftë si praktikë qoftë edhe si shprehje) në marrëdhëniet në mes shteteve: praktika e çnjohjeve. Janë rreth 13 shtete që e kanë çnjohur Kosovën. Dhe çka është edhe shumë më e rëndë, askush nuk ka dalur me një analizë sqaruese për opinionin që të dihen shkaqet dhe pasojat. Është një sjellje havakushi; fut kokën në rrëzë e le të dalë ku të dalë.

Natyrisht se përgjegjësinë kryesore për këtë gjendje e ka kryetari i Kosovës, Hashim Thaçi, pastaj kryeministri e sidomos ministri i Punëve të Jashtme, i cili për çdo ditë po dëshmon se, sidomos në këtë fushë, është një sharllatan me fletë.

Mjafton të analizosh sadopak punën, shprehjet dhe sjelljet e tij për t'u bindur menjëherë se ai nuk ka lidhje me resorin që mbulon. Për më keq, ai e ka paralizuar krejtësisht Ministrinë e Punëve të Jashtme (MPJ) duke krijuar aty një anarki të pabesueshme. Një gjendje për marre.

Kur flitet për Ministrinë e Punëve të Jashtme nuk duhet harruar asnjëherë edhe një fakt tjetër shtetërrënues «à la Hashim Thaçi»: kjo Ministri, për turpin e Kosovës, është formuar disa muaj pas Shpalljes së Pavarësisë! Që, në një mënyrë, i bie sikur prindërit që presin t'u lindë foshnja dhe ata s'kanë menduar se



Në shtetet normale, diplomatët janë ajka e mendjes së çdo kombi. Në emërimin e tyre nuk guxon të ketë nepotizëm, korruptim ose tarafilëk. Në këtë raste, ka vetëm tre kritere: përcaktimi i qartë atdhetar, aftësia dhe përgatitja intelektuale

u duhet djepi! Vetëm te Shqiptarët ndodhin këso marrëzishë!

Në fakt, po të kishte vetëm një minimum vetëdijeje shtetformuese te paria e Kosovës, Ministria e Punëve të Jashtme, pavarësisht pengesave të UNMIK-ut, është dashur të funksionojë, menjëherë pas zgjedhjeve të para, qoftë edhe në formë të një Zyreje për marrëdhënie me jashtë. Dhe në kuadër të saj të përgatitet gradualisht një

bërthamë efikase diplomatësh të karrierës, që do të bënin gati të gjitha dokumentet e nevojshme, dhe menjëherë pas Shpalljes së Pavarësisë e njohjeve të para të emërohen ambasadorët e parë dhe të fillojë një ofensivë efikase diplomatike.

Në shtetet normale, diplomatët janë ajka e mendjes së çdo kombi. Në emërimin e tyre nuk guxon të ketë nepotizëm, korruptim ose tarafilëk. Në këtë raste, ka vetëm tre kritere: përcaktimi i qartë atdhetar, aftësia dhe përgatitja intelektuale. Krejt kritere të tjera ka aplikuar sidomos Partia e Prontomafisë. Ajo ka mbushur MPJ me dashnore dhe familjar dashnore dhe kriter të rëndësishëm për të angazhuar personelin në këtë resor e ka bërë sh-

tratin si kusht.

Duhet pasur parasysh edhe faktin se trajtimi i diplomatëve, në çdo pikëpamje, nga vendi që ata përfaqësojnë shpjegon më së miri perspektivën e atij vendi. Në vitet kur jam marrë aktivisht me çështjen e Kosovës, kam mësuar shumë dhe kam parë se shtetet e dështuara më së miri dëshmonin erozionin e vet nga mënyra se si i trajtonin diplomatët e tyre. Shpeshherë ka ndodhur që ata nga përfaqësues, krejt papritur, të kthehen saora në refugjatë, mu në vendin ku deri dje përfaqësonin atdheun e tyre...

Shqipëria ishte njëri prej atyre vendeve dhe kur i shihja disa gjëra më skuqeshin edhe veshët nga marrja dhe më thahej fyti nga tri-

shtimi. Sepse shteti që poshtron diplomatin e tij, ai e poshtron dhe pështyen mbi çdo shtetas të vetin.

Kjo praktikë e neveritshme ka filluar edhe në Kosovë: në nëntor të vitit të kaluar, opinionin mësoi se Hashim Thaçi, kryetari i Kosovës e kishte shkarkuar ambasadorin tonë në Romë, zonjën Alma Lama. Motivi ishte i errët dhe vinte era hakmarrje personale e një kryetari mujshar që nuk ka haber se çka është as diplomati e as diplomacia.

Duke shkruar këta rreshta, shikova webin e MPJ dhe aty, akoma figuronte se ambasador i Kosovës në Romë vazhdon të jetë Alma Lama!

A mund ta marrë me mend cili do lexues se si ndihet ambasadorja jonë në Romë kur është shkarkuar në mënyrë skandaloze, përmes medieve?

Dhe përderisa kryetari i saj e i yni e trajton ashtu rrugaçërisht Zonjën Ambasadore, si mund ta trajtojë atë shteti ku ajo na përfaqëson dhe kolegët e saj diplomatë në Romë?

Për fund: nuk duhet të harrojmë asnjëherë se çnjohjet kanë filluar në momentin kur Hashim Thaçi, duke biseduar për ndryshimin e kufijve, ka vënë seriozisht në pyetje sovranitetin e Kosovës dhe vendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, sipas të cilës, Shpallja e Pavarësisë ishte një akt i ligjshëm.

(Marrë nga blogu: Xhafershatri.info)

RAMA, DERRAT E MEDIAVE DHE HALLATET E OPOZITËS...



Nga
Artur ZHEJI

Në fjalimin e tij zgjedhor, mbasi na rrëfeu shëndetin e tij të mirë fizik, kryeministri shpalosi gjithë agresivitetin e tij shpirtëror, mendtor dhe zemërak. Renditi të vërteta, gjysëm të vërteta dhe si gjithmonë një sallatë frutash bajate me shumë gënjeshtër, kësaj rradhe më të përmbajtura se herët e tjera.

Vërtet Tirana sot, në disa pamje është mjaft më e jetueshme, porse jeta bëhet më interesante, kur del jashtë saj dhe të mendosh që ushtria e kullave shumëkatëshe, të porositura drejtëpërdrejtë nga ay, duhet akoma të na pushtojë.

Kjo është e ardhshmeja e friksh-

me, që Veliaj, me Ramën kryeministër, do ta ketë të pamundur ta kundërshtojë dhe të drejtojë vrullin e investimeve në hekur dhe beton, drejt Paskuqanit, te Bulevardi i ri, për të krijuar aty, Tiranën e Rez. Përtej kësaj, zemëratat dhe zulmat e vrerit ishte pjesa dërmuese e fjalës kryeministore, ngjizur me helm të trashur gjarpri, të etur për revansh dhe hakmarrje, sepse punët e tij, nuk janë fare mirë. Dhe kjo është e dukshme dhe nuk mbulohet dot me mjegullën e fjalëve të tij, që ngjanin me një klithëm të papërmbajtur tërbimi, më shumë se sa me një arsytim kryeministrior.

Por pjesa më e ndjerë dhe më e

përsosur në metafora, ngjyresa, kthesa, karambole, emfaza, gëlbaza, drithërima, hakërrime, paralajmërime, kërcënime, shpërhyrime, erdhi te pjesa e spërkatjes me llum të Opozitës dhe të gazetarëve.

Lulëzim Basha, ishte sipas mllëfit të tij, që e ka burimin nga ditët e këqia dhe të paralajmëruara që po kalon, një "lider pa hallate", ndërsa gazetaret dhe analistët, thjesht ca "derra të shtrirë" nëpër studio televizive. Që pyll pa derra nuk ka, kjo dihet, por kësaj rradhe nga kanzaxhinj, gazetaret u shndërruan në fjalorin kryeministrior edhe në derra, kjo tingëllon e re dhe e dëshpëruar.

Për sa i përket "hallateve", kryeministri hyn dhe krejt gabim në këtë sfidë seksuale dhe riprodhuese të kundërshtarëve të tij politikë, sepse Basha ka dy fëmijë, Ilir Meta ka tre dhe madje edhe shumica e gazetarëve, na kanë qëlluar pjellorë, madje nganjëherë të përfolur, edhe si shumë të dhënë pas seksit, sepse kanë qëlluar mesdhetarë të mirëfilltë dhe hiperaktivë...

Por nejtë, mund të më thuhet se "hallatet" janë përdorur në kuptim figurativ, domethënë si njerëz mendërisht jopjellorë. Kryeministri le të mbajë në këtë fushë, peshoren e tij subjektive, si edhe ga-

zetarët kanë edhe ata, peshoren e tyre, në të cilën kryeministri, u rezulton gjithmonë e më i lehtë dhe më i papeshë.

Por kjo nuk i zgjidh hallet e tij... (a mos fjala "hallate" buron nga fjala "halle"? E që domethënë se kush ka halle, këto halle, ndikojnë te mbarëvajtja e hallateve?)

Ndoshta po dhe ndoshta jo. Gjykuar nga jeta e sotme e kryeministrit plot halle, e vështirë ta kesh zili, raportin e tij intim me vetminë dhe seksualitetin e vet, kur shkruan dhe merr mijëra mesazhe telefonike në ditë dhe kur ruhet me më shumë roje se presidenti i Rusisë.

Por kjo është një çështje tjetër...

STRAKOSHA NË RADARIN E TOTTENHAM

Tottenham është në kërkim të një portier dhe synon ta sjellë në Londër numrin një të Lazios dhe gardianin e Shqipërisë, Thomas Strakoshën, i cili thuhet ta ketë refuzuar Liverpoolin verën e kaluar. Sipas gazetës "Il Messaggero", Tottenhami e vlerëson shqiptarin si zëvendësuesin ideal të portierit francez Hugo Loris. Si gjithmonë. Presidenti i Lazios, Claudio Lotito është negociues i vështirë dhe i ka vënë një çmim prej 40 milionë euro Strakoshës. Sipas të njëjtës gazetë, Liverpooli e kishte bërë një ofertë prej 30 milionë euro për shqiptarin sezonin e kaluar, por Lazio e kishte refuzuar.



De Canio kandidat për ta marrë Kombëtaren

Të gjitha rrugët të çonin te Edoardo Reja, por mesa duket nuk do të jetë 73-vjeçari italian pasuesi i Christian Panuccit në stolin e kombëtares shqiptare. Tani, në skenë ka dalë një emër tjetër. Reja erdhi në Shkodër për ndeshjen Shqipëri-Turqi për të vëzhguar nga afër disa lojtarë dhe jo për të biseduar me Dukën për stolin e përfaqësueses shqiptare. Megjithatë mes kreut të FSHF-së dhe ish trajnerit të Napolit dhe Lazios pati një takim që gjithsesi nuk u mbyll me një shtrëngim duarsh pasi Reja e refuzoi kombëtaren shqiptare me arsyetimin se nuk ka futbollistët e përshtatshëm për të arritur objektiva madhorë. Tashmë në skenë ka dalë një emër i ri por që gjithsesi ka qenë në axhendën e presidentit Duka edhe përpara se ky i fundit të emëronte Panuccin si trajner i Shqipërisë. Bëhet fjalë për Luigi De Canio. 61-vjeçari nga Matera nuk ka përvojën e Edi Rejas por gjithsesi është një trajner me shumë eksperiencë që gjatë karrierës së tij ka drejtuar edhe skuadra të njohur si Udinese e Napoli. Për herë të fundit ai ka drejtuar Ternanën fillimisht në Serie B dhe më pas në Serie C, por në janar i këtij viti u shkarkua nga detyra dhe tashmë është i papunë. Megjithatë De Canio është një nga emrat e shumë në axhendën e presidentit Armand Duka i cili do të shqyrtojë me kujdes përpara se të marrë një vendim se cili do të jetë pasuesi i Panuccit te Shqipëria.

Me rastin e zgjedhjes për kryetar të ri të Federatës së futbollit të Maqedonisë së Veriut, në adresë të FFM-së kanë ardhur edhe urimet e presidentit të FIFA-s, Xhiani Infantino dhe presidentit të UEFA-s, Aleksander Ceferin

Koha Fisnik NUHIU

Shkup, 24 mars - Mes urimeve të shumta nga familja evropiane dhe ajo botërore e futbollit drejtuar Muhamed Sejdit me rastin e zgjedhjes për kryetar të ri të Federatës së futbollit të Maqedonisë së Veriut, në adresë të FFM-së kanë ardhur edhe urimet e presidentit të FIFA-s, Xhiani Infantino dhe presidentit të UEFA-s, Aleksander Ceferin. "Kryetar i nderuar, dua që sinqerisht t'ju përgëzoj dhe të shpreh urimet më të mira me rastin e zgjedhjes së juaj për kryetar të FFM-së. Ne jemi të bindur se njohurit tuaja, udhëheqja dhe përvoja e mëparshme si udhëheqës detyre, nënkryetar dhe anëtar i bordit Drejtues të federatës, sigurisht se do të ketë ndikim pozitiv për zhvillimin e mëtejshëm të futbollit në vendin tuaj. Ju gjithmonë mund të konsideroni në mbështetjen time persona-

CEFERIN DHE INFANTINO UROJNË SEJDININ



le dhe natyrisht mbështetje nga FIFA për të arritur qëllimet tuaja. Dyert e organizatës tonë gjithmonë do të jenë të hapura për biseda për të cilat do të mund të sjellin zhvillimin e lojës sonte. Kam nderin që t'ju ftojë në Cyrih dhe gëzohem për takimin tonë të radhës. Ju dhe gjithë stafit tuaj ju uroj shumë fat dhe suksese në sfidat e radhës", ka shkruar në urimin e tij presidenti i FIFA-s, Xhiani Infantino. Po ashtu edhe udhëheqësi i UEFA-s, Aleksandërs Ceferin ka dërguar urimin në adresë të



Muhamed Sejdit, ku në urimin e tij se nuk ka asnjë dyshim për zgjedhjen e Sejdit në krye të FFM-së. "Jam i lumtur t'ju përgëzoj me rastin e zgjedhjes për president të Federatës së Futbollit të Maqedonisë së Veriut. Njëkohësisht, dua t'ju falënderoj për udhëheqjen tuaj si ushtrues detyre gjatë muajve të kaluar, metëvërtet ndonjëherë nuk është lehtë që të jesh në një situatë të tillë. FFM u bashku me familjen tonë UEFA që nga viti 1994, ndërsa kemi një ndjen sikurse ka ndodhur



dje, por, fakt është se tani kanë kaluar 25 vite. Që atëherë janë bërë shumë punë, përfshirë renovimin e stadiumit zhvillimin e infrastrukturës, ndërtimi i kompleksit "shtëpia e futbollit", dhe qendra e trajnimit, që gjithsesi e vendosi organizatës si qendër e zhvillimit të futbollit në të gjitha nivelet. Ju dëshiroj gjithë të mirat në të ardhmen dhe nuk dyshoj se FFM është në duar të sigurta. UEFA-n gjithmonë do t'ju mbështet", thotë Aleksandar Ceferin.



Një ndeshje pa shumë histori, Marku e nisi rrufeshëm që në raundin e parë duke e rrëzuar në

Marku mund Ivan Godor me "KO"

tapet dy herë kundërshtarin e tij, i cili u ngrit për t'u ndeshur sërish. Gjithsesi në raundin e dytë do të ishte sërish e njëjta pamje, "Dinamiti" shqiptar lëshon një sërë grushtesh ndaj sllovakut, i cili bie sërish në tapet. Këtë herë ka ndërhyrë gjyqtari kryesor i takimit, duke ndërprerë ndeshjen dhe i dha fitoren që në raundin e dytë boksierit shqiptar, për të cilin kjo është ndeshja e dytë në boks, duke qenë se më parë ka luftuar në ka-

faz për ndeshje MMA. Ndeshja u zhvillua në "York Hall" në Londër, ku të gjithë mbështetësit ishin shqiptarë dhe i dhuruan emocion e brohoritje pa ndalur Florian Marku, i cili ua shpërbleu me një fitore të padiskutueshme. Marku bën pjesë në kategorinë "welterweight" (deri në 66.6 kg), ndërsa në fund të ndeshjes ai falënderoj të gjithë shqiptarët për mbështetjen që i dhuruan dhe lajmëroi se ndeshja e radhës do jetë më 27 prill.

XHAKA: Dua të hedh një hap tjetër

Granit Xhaka ka alarmuar Arsenalin me një intervistë të dhënë në Zvicër, atje ku është i grumbulluar me përfaqësuesen e tij për ndeshjet ndaj Gjeorgjisë dhe Danimarkës, të vlefshme për kualifikueset e Euro 2020. Mesfushori me origjinë shqiptare zbuloi se babai i tij, Ragip Xhaka, i bën analizën e lojës pas çdo ndeshje dhe theksoi: "Unë jam shumë ambicioz, dua të hedh një hap tjetër të madh. Kjo nuk do të thotë se Arsenali është ndalesa ime e fundit", ka deklaruar Xhaka. Kaq ka mjaftuar dhe mediet në Angli kanë filluar të ndezin më shumë situatën rreth largimit të Xhakës, i cili vetëm një vit më parë rinovoi kontratën për 5 vitet e ardhshme. 26-vjeçari tha se me pozicionin e ri që i ka vendosur trajneri Emery në fushë ndihet më mirë, luan më shumë, ka më shumë hapësirë përpara dhe nuk ka nevojë të bëjë ndërhyrje të ashpra, që e kanë penalizuar me kartonë.

LIGA E DYTË: PERËNDIM - LINDJE

Derbi i shqiptari i takoi Gostivarit

Shkup, 24 mars - Janë zhvilluar ndeshjet e javës së 17 në Ligën e dytë të Maqedonisë së Veriut - Perëndim dhe atë Lindje. Derbi shqiptarë midis Gostivarit dhe Vëllezërimit të Kërçovës i takoi skuadrës vendase, që në fund shënoi fitore me rezultatin 3:2. Skuadra e Struga Trim Lum edhe në përballjet e tretë të sezonit pranveror nuk ka arritur të merr fitore. Skuadra e udhëhequr nga trajneri, Jeton Beqiri ka barazuar në shtëpi pa gola

përballë Skopjes. Nga ana tjetër Labunishti ka pësuar disfatë në Manastir nga Pelisteri, ku vendosi goli i vetëm i shënuar nga Bllagoja Ljamçeviski në minutën e 59 nga penaltia. Teteksi ka regjistruar edhe fitoren e tretë me radhë në stinorin pranveror. Skuadra tetovare mundi Korabin me rezultatin 2:1. Skuadra e Borecit ka vazhduar me rezultatet e mira, kësaj radhe duke fituar skuadrën e Kit GO me rezultatin 2:1. Boreci arriti edhe fitoren e



tretë nga po aq ndeshje në stinorin pranveror, duke u konfirmuar si kandidati më serioz për pozitën e parë dhe inkuadrimit në Ligën e Parë Futbollistike të Maqedonisë. Në takimet tjera Bregallnica shënoi plotë 6 gola si mysafire e Pllaço-

vicës. Kozhuvit me rezultatin minimal 1:0 mundi Vardar Negotinën, ndërkohë Tikveshi dhe Detonit Junior si mysafir shënuan fitore identike 0:2 në ndeshjet në transfertë, përballë Partizan Obrshanit, gjegjësisht Sasas. (F.N)

HAZARD: AI HAMBURGER MË BËRI LEGJENDË TË BELGJIKËS



“Salca e atij hamburgeri ishte gjëja që më pëlqente më shumë. Ende e kërkoj nga nëna ime të ma sjellë kohë pas kohe edhe në Londër. E pranoj, kam bërë një marrëzi. Kjo është historia e hamburgerit. Ne ende qeshim, kur e kujtojmë në kombëtare. Mendoj se kjo histori më bëri legjendë të ekipit kombëtar”, rrëfeu Hazard

Eden Hazard është ndër lojtarët e mëdhenj të momentit, por ka pasur kohë për të bërë gabimet e tij në rini. Dy prej tyre kanë qenë më të përfolurit. Në maj të vitit 2012, Hazard e pranoi sfidën e madhe të karrierës së tij, kur nënshkroi me Chelsea-n, para se ta përfundonte sezonin e tij me Lille. Me sa duket, ditën kur nënshkroi me blutë e Londrës shkoi për të festuar me shokun e tij të skuadrës, Rio Mavuba, deri në orët e vona të mëngjesit. Deri aty duket se asgjë nuk ishte e pazakontë, por të nesërmen kishte ndeshje. “Ne vendosëm të shkonim për të pirë dhe

darkuam jashtë. Të nesërmen në mëngjes, Eden ishte ende i dehur. Ai nuk fjeti, piu gjithë natën dhe shëmoi tre gola”, tha Mavuba. Kjo histori njihet falë ish-partnerit të tij dhe belgu nuk e ka pranuar kurrë, por tani e dimë se tjetra është e vërtetë. Hazard u largua për të ngrënë një hamburger në mes të një ndeshjeje me Belgjikën. Lojtari i kërkuar me ngulm nga Real Madridi u zëvendësua në minutën e 60-të të ndeshjes kundër Turqisë në vitin 2011 dhe vendosi të largohej nga stadiumi për të ngrënë një hamburger me anëtarët e familjes. Trajneri i atëhershëm i

kombëtares belge, Georges Leekens, e pezulloi atë për dy ndeshjet e ardhshme (kundër Sllovenisë dhe Azerbajxhanit). Tetë vite më vonë, Hazard rrëfen “arratisjen” dhe supozon se kjo ngjarje e ka bërë atë një legjendë të Belgjikës: “Salca e atij hamburgeri ishte gjëja që më pëlqente më shumë. Ende e kërkoj nga nëna ime të ma sjellë kohë pas kohe edhe në Londër. E pranoj, kam bërë një marrëzi. Kjo është historia e hamburgerit... Ne ende qeshim, kur e kujtojmë në kombëtare. Mendoj se kjo histori më bëri legjendë të ekipit kombëtar”, – rrëfeu Hazard në një intervistë me RTBF. Bel-

gu, gjithashtu foli për të ardhmen e tij me Belgjikën, tani që ai do të rumbullakosë 100 ndeshje për ekipin kombëtar. “Unë nuk kam vendosur një qëllim sa ndeshje do të arrij. Gjithmonë e kam thënë se do të luaj deri sa të mbajë trupi im, por gjithashtu do të varet nga brezi i ardhshëm. Nëse e shoh se një lojtar i ri e meriton pozicionin tim, do të largohem. Jam ende i ri, por mendoj se Courtois do ta thyejë rekordin tim. Ndoshta ai do të luajë derisa të jetë 38 vjeç. Ndoshta do të imitojë Buffonin dhe do të luajë edhe mbi 40 vjeç. Do të përpiqem të luajë aq sa Thibaut”.



Inter përgatit blerjen e bujshme

Ka fituar shumë tituj te skuadra e Real Madrid, ku nuk ishte asnjëherë titullar. Kjo solli huazimin për një sezon te Chelsea, ku dhe po luan aktualisht. Por çdo të ndodhë verën e ardhshme për mesfushorin kroat Mateo Kovacic? Lajmi i bujshëm vjen sot nga Italia: kroati është pranë rikthimit tek Interi, ku luajti për dy sezone: 80 ndeshje dhe 5 gola për nënkampionin e botës. Sipas “Corriere Dello Sport”, Beppe Marotta ka kontaktuar drejtuesit e Real, dukle bërë një sondazh për të kuptuar nëse ekziston mundësia që Kovacic të rikthehet në Milano. Përgjigjja nga klubi madrilën ka qenë pozitive. Gjithsesi, kjo nuk do të thotë gjithçka, pasi duhet edhe përgjigjja e lojtarit, nëse pranon të rikthehet në Serinë A. Kovacic ka deklaruar disa herë që ndihet mirë në Londër. Nuk dihet nëse Marotta kërkon ta sjellë lojtarin në formë huazimi, apo zikaltërit do të paguajnë 30 milionë euro për lojtarin. Vështirë se Kovacic qëndron sërish në Madrid, ku sërish do të ngrohete stolin, ndaj Inter shpreson të gjejë një marrëveshje për të sjellë sërish 24-vjeçarin në Milano.

Bomba e merkatos, Juventus pas Salah



Vijojnë të përforcimet zërat e bujshëm sa i përket merkatos së fuqishme që pritet të konkretizojë Juventus në merkaton e verës. Në këtë kuadër, emri që më shumë ka shkundur të gjithë ambientin futbollistik në Itali dhe Angli, por jo vetëm, është ai i egjiptianit Mohamed Salah. Ylli i Liverpool është aluduar edhe më parë për një afrim të mundshëm te “Zonja e Vjetër”, por tashmë gjërat duket të jenë më konkrete. Pikërisht, sepse

bardhezinjtë kanë një ofertë konkrete për të bindur “Të Kuqtë” të lënë të lirë bomberin egjiptian. Referuar të përditshmes britanike “Daily Mail”, Juventus ka përgatitur superofertën për të siguruar shërbimet e Salah: plot 60 milionë euro dhe kartonin e argjentinanit Paulo Dybala. Kështu, veç përforcimit të sulmit, Juventus do të shënonte një tjetër goditje të fuqishme marketingu, pas asaj të verës së kaluar me Cristiano Ronaldo.



Atletico kërkon 80 milion euro për Thomas

Ndërkohë që Atletico Madrid është pranë firmës me Hector Herrera, Simeone mendon edhe për lojtarët që kanë marrë oferta apo dëshirojnë të largohen. Mesfushori ganez, Thomas është njëri prej tyre por trajneri argjentinasi ia ka bërë të qartë drejtuesve bashkë me lojtarin që nuk do të largohet edhe nëse një ekip do të paguajë klauzolën prej 80 milionë euro. 25-vjeçari shihet si titullar dhe Simeone mendon se ai bashkë me Saul, Koke dhe Herrera do të mbulojnë plotësisht repartin.

United 250 milionë euro për 3 talente të Portugalisë

Skuadra e Manchester United është gati të paguajë 250 milionë euro për të sjellë në “Old Trafford” 3 talente të kombëtares portugeze të futbollit. Bëhet fjalë për sulmuesin 19-vjeçar të Benfica, Joao Felix; mbrojtësin 21-vjeçar të Benfica, Ruben Dias si dhe për mesfushorin 24-vjeçar Bruno Fernandez, që luan me Sporting. Tri futbollistë që janë pjesë e ekipit kombëtar “luzitan” dhe që po shkëlqejnë në skuadrat e tyre. Sipas të përditshmes britanike



“The Mirror”, skuadra e Manchester United kërkon të përsëritë edhe një herë historinë, duke synuar që të sjellë në Premier një tjetër Cristiano Ronaldo. Natyrisht që nuk ka për të qenë e lehtë për United të realizojë këtë blerje të 3-fishtë, pasi për këta lojtarë janë interesuar edhe Manchester City, Real Madrid, Barcelona e Juventus. Ndaj “djajtë” kanë rritur ofertën, për të bërë të mundur një blerje “në grup” dhe të evitojë konkurrencën.



Mësoj çdo ditë nga CR7 ndonjë truk të ri

Debutimi si titullar me fanellën e Italisë ka qenë i jashtëzakonshëm për 19-vjeçarin Moise Kean, që realizoi gol në fitoren 2-0 që "azzurrët" arritën ndaj Finlandës. Ai bëhet futbollisti i dytë më i ri në moshë që shënon gol me fanellën e Italisë, pas Bruno Nicole (18 vjeç), por thyen rekordin e një legjende si Gianni Rivera. "Theva rekordin e Rivera? Ky është një motiv më shumë për mua, për të punuar edhe më shumë në të ardhmen. Kam ende shumë rekorde të tjerë përpara për të thyer dhe jam gati", u shpreh Kean, 19-vjeçari që luan në Serinë A me Juventusin. Kean shënoi golin e dytë për Italinë, në minutën e 74-t, kur finalizoi me sukses një asist të Immobile, që e nxori të lirë para portierit finlandez.

"Stërvitem çdo ditë dhe përpiqem të jem gati sa herë që skuadra ka nevojë për mua. Goli ishte një emocion i jashtëzakonshëm. A mësoj ndonjë truk nga Ronaldo? Sigurisht, është e pamundur të mos mësosh prej tij, sidomos kur ke në krah një kampion të madh si ai. Çdo ditë e shoh dhe mësoj prej tij", tha Kean.

POGBA E DËSHIRON TRANSFERIMIN TE REALI

Pogba dhe agjenti i tij, Mino Raiola, janë duke e kërkuar një rrugë për t'u larguar nga klubi anglez. Francezi duket se e ka qartësuar mendjen e tij dhe është i sigurt se e dëshiron transferimin në Real Madrid

Ditët e Paul Pogbës në Manchester United mund të jenë të numëruara, pasi që mesfushori francez dhe agjenti i tij, Mino Raiola, janë duke e kërkuar një rrugë për t'u larguar nga klubi anglez. Francezi duket se e ka qartësuar mendjen e tij dhe është i sigurt se e dëshiron transferimin në Real Madrid, raporton Marca. Problemi i tij i vetëm është se drejtuesit e Manchester Unitedit nuk dëshirojnë ta lejojnë largimin e futbollistit për të cilin paguan 114 milionë euro në vitin 2016. Sado që koha e tij nën drejtimin e Jose Mourinhon nuk ishte e suksesshme, 26-vjeçari është përmirësuar dukshëm nën drejtimin e Ole Gunnar Solskjær. Pogba është duke e dëshmuar veten tani, pjesërisht falë edhe ndihmës së Nemanja Matitit dhe Ander Herreras. Përderisa Zinedine Zidane mund të dëshirojë ta



ketë atë në skuadër, ka të tjerë në Real Madrid që kanë dyshime për këtë transferim, pasi që prioriteti i tyre është ta gjejnë një zëvendësim për Luka Modricin. Për më tepër, është ende e paqartë se sa do të kushtonte Pogba nëse "Los Blancos" kërkojnë ta transferojnë atë

gjatë afatit kalimtar të verës. Në kontratën e francezit me "Djajtë e kuq" nuk ka klauzolë për shkëputjen e kontratës. Për këtë arsye, Real Madridi mund të detyrohet të shpenzojë një shumë rekord, pasi që Pogba u transferua në Manchester United për 114 milionë

euro. Nuk ka shumë futbollistë që mund të krahasohen me Pogbën, mirëpo Barcelona ka paguar 75 milionë euro, shumë kjo që mund të ngrihet në 86 milionë euro, për Frenkie de Jong. Mirëpo, holandezi është në një fazë plotësisht tjetër të karrierës së tij.

Sancho: Nuk dua të përfundoj si shumë yje që shuhën shpejt

Në një intervistë të dhënë në YouTube, sulmuesi 18-vjeçar anglez i Borussia Dortmund, Jadon Sancho, ka folur për karrierën e tij të re dhe se ku synon të shkojë në të ardhmen. "Jam ende adoleshent, shumë i ri për të qenë një yll. Kam parë shumë talente që janë shuar shumë shpejt, pasi u rritën shumë shpejt", tha Sancho. "Gjithsesi, çdo sportist ka jetën e

karrierën e tij, ka kokën e tij që merr vendime. Gjithsesi, shumë të tillë janë djegur shumë shpejt. Për fat, kam disa persona të jashtëzakonshëm pranë meje, që më mbajnë afër dhe falë tyre jam një njeri i thjeshtë", u shpreh më tej Sancho. 18-vjeçari anglez që luan me Borussia Dortmund prej vitit 2017 kërkohet nga shumë skuadra, kryesisht në Premier

League, që duan ta sjellin sërish në vendlindje, aty ku është rritur. Në 38 ndeshje me Borussia ai ka realizuar 9 gola. "Do të dëgjoj këshillat e të gjithëve. Unë mendoj të luaj sa më shumë, pasi e di që nuk kam dhënë ende më të mirën time. Jam ende shumë i ri për të qenë një idhull. Nuk e kuptoj ende gjithë këtë famë", tha Sancho.



Shevchenko: Më pëlqen shumë Allegri si trajner, frymëzohem prej tij



Legjenda e Milanit, Andriy Shevchenko, në një intervistë për "Tuttosport", ka rrëfyer se si ndihet në aventurën e tij të ri të trajnerit. Prej 2 vitesh ai drejton kombëtarin e Ukrainës dhe pas barazimit 0-0 që ekipi i tij arriti ndaj Portugalisë, Shevchenko thotë dy fjalë edhe për Cristiano Ronaldo, të cilin e kishte rival në fushë. "Ishte Ronaldo i zakonshëm, i ri dhe i rikuruar për të fituar gjithnjë. Nuk duket se është 34 vjeç. Juventus

ishte i fortë edhe pa të, por tani që mori edhe një yll si CR7 mund të arrijë objektivat e pamundur më parë. Këtë sezon bardhezinjtë mund ta fitojnë Champions League", tha Shevchenko. Duke folur për aventurën e tij si trajner, ukrainasi thotë se shpesh ndeshjet e Juventusit. Arsyja? "Më pëlqen shumë Allegri si trajner, frymëzohem prej tij. Është i aftë të menaxhojë lojtarët dhe të motivojë grupin. Është trajneri i

përkryer për kampionët. Kur ke lojtarë të mëdhenj duhet t'u besosh atyre dhe Max e bën këtë gjë. Mësoj shumë prej tij" tha Shevchenko. "Si është aventura si trajner? E vështirë, pasi duhet të transmetosh idetë e tua te skuadra. Ndihehem i aftë 100% për ta bërë këtë detyrë. Mendoj, arsyetoj dhe sillem krejt ndryshe nga koha kur isha lojtar. Jam i përqendruar te grupi i lojtarëve që kam, mendoj shumë dhe fle më pak", tha Shevchenko.

MARTI, E GJETUR SI FOSH NJË QË PO VDISTE, TASH ËSHTË SKITARE NDËRKOMBËTARE

“Unë kam një thënie: Nëse ke ëndërr, atëherë ec dhe shko drejt saj. Fillimi i garës është moment i vështirë, por kur arrin në finish është shumë emocionuese. Më pëlqejnë gjërat e vështira. Ky është shpirti im”, thotë skitarja nga Haiti




Me zemër duke i rrahur shpejt dhe duke pasur edhe dridhje në bark, Celine Marti gjendet në portën e startit dhe mundohet të kontrollojë frymëmarrjen. Pak sekonda para fillimit, ajo shikon shpatin para saj dhe mendon për vazhën e saj, prindërit dhe po ashtu për banorët e Haitit që po i përfaqëson. Përkundër të gjitha sfidave, ajo ia ka dalë. Kur kronometri bën “bip” për fillimin e garës, ajo del nga porta dhe lëshohet poshtë malit. Ndihet e lehtësuar. Derisa 39-vjeçarja ka-

lon vijën e finishit, ajo ngre duart lart dhe bën tifozëri për vete me buzëqeshjen e saj “infektuese”, shkruan CNN. Ishte një shpërthim i ndjenjave, rrëfen ajo. Marti përfundoi garën e 52-ta, në disiplinën e sllallomit në Kampionatin Botëror të skijimit alpin që u mbajt muajin e kaluar. Ishte mbi një minutë prapa kampiones Mikaela Shiffrin. Dy ditë më herët ajo kishte përfunduar e 82-ta në disiplinën e sllallomit të madh. Mirëpo,

pjesëmarrja e saj në Are të Suedisë kurrë nuk kishte qëllim fitoren. Ajo nuk skijon për të fituar. Ka të bëjë me dashurinë, vendosmërinë dhe tejkalimin e vështirësive të mëdha që ka pasur në jetë. “Unë kam një thënie: Nëse ke ëndërr, atëherë ec dhe shko drejt saj. Fillimi i garës është moment i vështirë, por kur arrin në finish është shumë emocionuese. Më pëlqejnë gjërat e vështira. Ky është shpirti im”, thotë skitarja nga Haiti. Si

bebe, Marti që do të mbushë 40 vjet në prill, u gjet në rrugët e Haitit nga punëtorët misionarë. Ajo u adoptua nga një çift zviceran nga Gjeneva, që injoruan paralajmërimet se Marti nëntëmuajshe atëkohë nuk do të jetojë edhe shumë gjatë. “Është e vështirë të di saktësisht se çfarë kisha, por nuk isha mirë me shëndet”, rikujton Marti, që tash ka një fëmijë të adoptuar vetë dhe punon si police në Aeroportin e Gjenevës.



Alonso, pas dy javësh sërish në pistën e Formula 1 me McLaren

Fernando Alonso pritet të testojë makinën McLaren më datat 2-3 prill, në pistën e Bahrein, pas garës së Çmimit të Madh të Bahrein, që do të zhvillohet aty më 31 mars. Sipas të përditshmes “Autosport”, piloti spanjoll do të provojë makinën e re McLaren, që këtë sezon përdor motorin Renault. Për momentin ky test do të shërbejë vetëm për të kuptuar se ku duhet punuar, në mënyrë që makina britanike të jetë sa më e shpejtë në të ardhmen. Gjithsesi, ky test konsiderohet edhe si një hap i parë i njohjes së spanjollit me njëvëndëshen e re, të cilën mund ta pilotojë sërish vitin 2020. Pavarësisht se u largua nga McLaren dhe Formula 1 në fund të sezonit të kaluar, Alonso ka ende një marrëveshje me makinën britanike, duke qenë ambasador i saj. Këtë sezon, spanjollit garon në Botërorin e Endurance, ku ka fituar 3 nga 6 garat e zhvilluara deri më tani dhe kryeson renditjen. Problem është se më 3 prill Alonso duhet të testojë edhe makinën e tij Toyota, në prag të garës së SPA (Belgjikë) e vlefshme për Botërorin e Endurance. Në rast se nuk arrin të provojë makinën McLaren në Bahrein, spanjollit ka ende një shans të dytë në testet që do të kryhen në gusht, pas garës së Hungarisë.

McGregor lobon për revanshin

Conor McGregor nuk mendon vetëm për rikthimin në kafaz, por synon edhe një revansh me boksierin Floyd Mayweather. “Ai i mori paratë e tij nga ajo përballje dhe më pas u largua. Gjithsaesi, ai duhet të rikthehet në ring dhe unë do të jem sërish përballë tij. Do të jem gati për të dhe me besimin për fitore”, u shpreh Conor McGregor. Në gusht të vitit 2017, irlandezi bëri debutimin e tij si boksier, në një duel me të pamposhtur Mayweather, që fitoi me “KO teknik” në raundin e 10-të. Në atë sfidë “Notorious” bëri një paraqitje të

mirë, sidomos në raundet e parë dhe më pas ishte Mayweather ai që dominoi. Ajo sfidë gjeneroi 4.3 milionë PPV (pay per view-paguaj për ta parë). “Unë besoj se revanshi mund të ndodhë në të ardhmen, është një sfidë që gjeneron shumë parë. Pse jo të mos e organizojmë sërish këtë sfidë. Unë e kam gati stafin tim për këtë duel të madh. Me besoni, këtë herë do ta çoj kokën e tij në shkallët e stadiumit me grushtet e mi”, u shpreh McGregor, duke thumbuar boksierin amerikan (50 fitore e asnjë humbje për Mayweather).



NBA

Golden State i përulet Nowtizkit, Dallas i jep leksion

Golden State bën harakiri, mposhtet turpshëm nga Dallas Mavericks në Oracle Arena dhe humbet vendin e parë në Konferencën e Perëndimit, vetëm pak ndeshje përpara fundit të sezonit, një pozicion që e mbante prej disa muajsh por tashmë i përket Denver Nuggets. Warriors pësuan disfatën e 23-të sezonale pasi u thyen nga Dallas Mavericks me rezultatin e thellë 91-126, në një ndeshje që nuk kishte aspak histori dhe që u zgjidh që në pjesën e parë. Dallas u rikthye te fitorja pas 3 humbjesh rresht falë edhe ve-

teranit gjerman Dirk Nowitzki i cili zhvilloi paraqitjen e tij më të mirë në këtë sezon që është edhe i fundit për të në karrierë duke realizuar 21 pikë. I magjishëm edhe talenti sloven Luka Doncic që realizoi një triple-double për skuadrën teksane duke koleksionuar në total, 23 pikë 10 asiste dhe 11 rebound. Ndërkohë te Golden State më i miri ishte Kevin Durant me 25 pikë. Vijon forma shumë e mirë e Portland Trail Blazers që regjistroi fitoren e 6-të në 7 ndeshjet e fundit pasi mposhti në Moda Center me rezultatin 117-

112, Detroit Pistons. Damian Lillard me 29 pikë 9 asiste dhe 6 rikuperime ishte basketbollisti më i mirë mbi parket për Blazers ndërkohë që te Detroit spikati i përhershmi Blake Griffin, autori i 27 pikëve. U rikthyer menjëherë te suksesi edhe Utah Jazz një fitore që e ngjiti në vendin e 5-të në Perëndim skuadrën nga Salt Lake City. Në transfertën e Illinois ndaj Chicago Bulls, Utah triumfoi lehtësisht me rezultatin 114-83 për meritë edhe të francezitet Rudy Gobert që koleksionoi 21 pikë dhe 14 rikuperime.





Thaçi: UÇK dhe NATO detyruan kapitullimin e Millosheviçit

Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, duke kujtuar 20-vjetorin e bombardimeve të NATO-së, është shprehur se marsi i vitit 1999 ishte pikënisje e ndalimit të gjenocidit dhe rikthim i shpresës sonë për liri e pavarësi. Ndër të tjera përmes një postimi në rrjetin social Facebook, shkruan se UÇK-ja në tokë dhe NATO-ja në ajër, në luftën e përbashkët për paqe, e detyruan kapitullimin e regjimit të Millosheviçit.

"Pas dështimit të përpjekjeve diplomatike për ta detyruar Serbinë që t'i ndërpriste ofensivat brutale dhe masakrat mbi popullsinë civile në Kosovë, ish-sekretari i NATO-s, Javier Solana, më 23 mars 1999 kishte urdhëruar fillimin e sulmeve të NATO-s kundër forcave serbe. Edhe sot kur i kujtojmë këto ditë, dy dekada pas, e kemi të freskët gëzimin e madh që përjetuam në ato momente tejet të vështira për popullin tonë. Kjo ishte pikënisje e ndalimit të gjenocidit dhe rikthim i shpresës sonë për liri e pavarësi. UÇK-ja në tokë dhe NATO-ja në ajër, në luftën e përbashkët për paqe, e detyruan kapitullimin e regjimit të Millosheviçit. Intervenimi i NATO-s, i cili ndaloi spastrimin etnik, na obligon edhe më shumë që me përkushtim të shtuar institucional dhe politik t'i ruajmë dhe t'i garantojmë të drejtat e të gjitha komuniteteve që jetojnë në vendin tonë. Republika e Kosovës është dhe do të jetë përherë atdhe i përbashkët i të gjithë qytetarëve të saj."

ALARMI I MEDIAS SË VATIKANIT

DO TË KEMI EKSOD SHQIPTAR SI NË '90!

Sot populli shqiptar po tregon maturi dhe duket se vendi ka nxjerrë mësimet e duhura nga historia. Por prapëseprapë mbetet droja se nëse do të vijojë të mos garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, do të përballemi me një tjetër "Rasti Shqipëria", që vjen së bashku me rrezikun e një vale emigrimi të ngjashme me atë të viteve '90."

Djegia e mandateve nga opozita dhe kriza politike e krijuar në Shqipëri është duke marrë vëmendje maksimale në shtypin ndërkombëtar. Së fundmi për situatën e rëndë që është krijuar ka shkruar edhe e përditshma e Vatikanit, "L'Osservatore Romano".

Në artikull nënvizohet se situatë në Shqipëri karakterizohet nga tensione gjithnjë e në rritje dhe me rrezikun e një vale të re eksodi.

Gazeta zyrtare e Vatikanit, sjell në vëmendje qëndrimin e ndryshëm të palëve për zgjidhjen e krizës dhe pasojat e saj.

Sipas "L'Osservatorio Romano", megjithëse situata nuk ka krahasim me 97-ën, "mbetet droja se, nëse do të vijojë të mos garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, do të përballemi me një tjetër "Rasti Shqipëria", që vjen së bashku me rrezikun e një vale emigrimi, të ngjashme me atë të viteve '90."

"Një tjetër manifestim proteste me mijëra pjesëmarrës u zhvillua dje në kryeqytetin shqiptar, para selisë së Parlamentit. Manifestimet po mbahen me nismën e Partisë Demokratike, formacion opozitar i qendrës së djathtë, i udhëhequr nga Lulzim Basha, tashmë figura-simbol e protestave që prej javësh po vlojnë në Tiranë.

Duke denoncuar kthimin e Shqipërisë në stadin e varfërisë, Ba-



sha ka kërkuar largimin e qeverisë së drejtuar nga socialisti Edi Rama, i akuzuar për korrupsion dhe lidhje me krimin e organizuar; largim që do t'i mundësonte vendit të shkonte në zgjedhjeve të parakohshme.

Në mbrojtje të selisë së parlamentit ishin angazhuar rreth 700 forca policore. Gjatë mobilizimeve të mëhershme, protestat u shndërruan herë pas here edhe në përplasje të dhunshme, çka solli që policia të përdorte gazin lotsjellës dhe makinat e ujit për të zbrapsur protestuesit që kërkonin të hynin në selinë e parlamentit apo në atë të qeverisë.

Nga ana e saj, qeveria vijon të këmbëngulë se sjellja e opozitës është një pretekst për të vështirësuar çeljen e negociatave të anëtarësimit të Shqipërisë në BE, vendim i planifikuar për t'u marrë

qershorin e ardhshëm.

Pikërisht lidhur me këtë temë, po rritet droja në Bruksel se degjenerimi i protestave mund të vërë me të vërtetë në rrezik nisjen e negociatave. Para disa ditësh, një delegacion i BE-së që ishte në Tiranë konfirmoi të drejtën themelore të të gjithë qytetarëve shqiptarë për të protestuar paqësisht, pa përdorur dhunë, duke saktësuar se "asnjë akt dhune nuk do të ishte i tolerueshëm". Anëtarët e delegacionit kritikuan zgjedhjen e opozitës për t'u larguar nga parlamenti dhe u bënë thirrje të dyja palëve që të tregonin përgjegjshmëri. Kapërcimi i krizës aktuale politike dhe ndërtimi i një platforme kombëtare dialogu ku të marrin pjesë të gjitha palët e interesuara është propozimi i ardhur nga Bashkimi Evropian.

Ekziston rreziku që Shqipëria të shihet sërish nga komuniteti ndërkombëtar me syrin mosbesues që shpesh e ka klasifikuar vendin ballkanik si të dhunshëm dhe të paafatë të vendosë drejtësi e të ndjekë politikën e duhura sociale. Gjithsesi, situata e brendshme është ndryshe nga 1997-a, kur pas një vale protestash të forta, vendi u zhyt në anarki.

Sot populli shqiptar po tregon maturi dhe duket se vendi ka nxjerrë mësimet e duhura nga historia. Por prapëseprapë mbetet droja se nëse do të vijojë të mos garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, do të përballemi me një tjetër "Rasti Shqipëria", që vjen së bashku me rrezikun e një vale emigrimi të ngjashme me atë të viteve '90", shkruan "L'Osservatore Romano".

Digjen flamujt e SHBA dhe BE-së në Beograd

Pjesëtarë të Partisë Radikal serbe sot, në 20 vjetorin e fillimit të bombardimeve të NATO-s kundër caqeve ushtarë e policore të Serbisë kanë protestuar kundër Bashkimit Evropian dhe NATO-s. Udhëheqësi i Partisë Radikale Serbe, Vojislav Sheshel, i ka vënë flakën flamuri të Bashkimit Evropian dhe të NATO-s. Sheshel me këtë rast tha se, do t'i kërkojë Ser-

bisë të heqë dorë nga rruga e saj drejt BE-së, ku, siç tha ai, "të gjithë armiqtë serbë", ishin të përqendruar. Ai kërkoi që autoritetet në Beograd të angazhohen gjithnjë e më shumë në mbrojtjen e serbëve përpara gjykatës së Hagës. Para ecjes, Sheshel tha në tubim se 20 vjet më parë ndodhi një bombardim i egër i krimit të popullit serb dhe vrasja e fëmijëve serbë.



Kosnetti: SHBA-të mbështeten NATO-n për t'i dhënë fund spastrimit etnik në Kosovë



Ambasadori i Shteteve të Bashkuara në Kosovë, Philip Kosnett, ka thënë se 20 vjet më parë SHBA-ja ka mbështetur intervenimin e NATO-s për t'i dhënë fund regjimit të spastrimit etnik të Millosheviçit, pas dështimit të përpjekjeve diplomatike për të arritur një zgjidhje paqësore.

Në një adresim në 20-vjetorin e bombardimeve të NATO-s, ambasadori Kosnett ka pohuar se tani është koha që Kosova dhe Serbia të

ndërtojnë shoqëri ku të gjitha komunitetet jetojnë bashkë në paqe dhe me dinjitet.

Ai ka bërë thirrje që të shtohen përpjekjet për zbardhjen e fatit të personave të pagjetur në Kosovë.

"Pra sot, si reflektim – unë bëj thirrje për veprim. Inkurajoj qeveritë e Kosovës dhe Serbisë të garantojnë se viktimat dhe familjet e tyre të të gjitha kombësive dhe komuniteteve kanë qasje të plotë në informata për fatin e të zhdukurve.

Si dhe bëj thirrje tek të dyja qeveritë të rrisin përpjekjet për të vendosur drejtësi për viktimat e krimeve të luftës", është shprehur Kosnett.

Ambasadori Kosnett ka thënë se në këtë 20 vjetor, duhet të përkujtohen qindra mijëra viktimat të pafajshme, që lëshuan shtëpitë e tyre dhe ata që u zhdukën.

Shtetet e Bashkuara, ka thënë ai, kanë vepruar për të garantuar paqe dhe stabilitet në rajon.

MIJËRA PROTESTUES NË LONDËR BËJNË THIRRJE PËR REFERENDUM

Pas tre vitesh debate të pafundme, Brexit-it duket sërish i largët dhe një pjesë e politikanëve problemin e gjejnë tek May. "Është e patolerueshme, situata në të cilën jemi, druhem se është ajo problemi", tha Anna Soubry, ligjvënëse pro-Bashkimit Evropian



Mijëra protestues që kundërshtojnë daljen e Britanisë nga Bashkimi Evropian, me thirrjet "Le të vendos populli", janë mbledhur për të marshuar në Londër të shtunën, për të bërë thirrje për referendum të ri për shkak të krizës së marrëveshjes së Brexit-it. Pas tre vitesh të debatit pafund, ende është e paqartë nëse Brexit do të ndodhë përderisa kryeministrja Theresa May po planifikon të dalë nga kriza e thellë politike.

May deklaroi se mund të mos e sjellë në Parlament marrëveshjen e ndarjes nga Bashkimi Evropian. Mediat lokale raportojnë se presioni ndaj May për dorëheqje po rritet.

"Është e patolerueshme, situata në të cilën jemi, kam frikë se

Theresa është problemi", tha Anna Soubry, ligjvënëse pro-Bashkimit Evropian.

"Ajo duhet të largohet dhe ne kemi nevojë për një kryeministër të përkohshëm që vendos vendin në rend të parë. Kjo është ajo pse po marshojmë sot", tha ajo.

Përderisa vendi dhe politikanët janë të ndarë për Brexit-in, shumica pajtohen se është vendimi strategjik më i rëndësishëm që nga Lufta e Dytë Botërore.

Kryeministres së Britanisë së Madhe, Theresa May, i mbetet tani të bindë ligjvënësit e vendit që të mbështesin planin e saj për largim nga Bashkimi Evropian, pasi BE-ja propozoi shtyrje të Brexit-it përtej 29 marsit, datës së paraparë ak-

tualisht.

Aleatët e paktë të Theresa May-t u angazhuan mbrëmjen e së shtunës në një betejë të dëshpërur për t'i mbrojtur kryeministres pozitën, duke paralajmëruar se një largim i detyruar i saj, do ta çonte vendin drejt zgjedhjeve të përgjithshme dhe do ta ndante partinë në dysh, transmeton Top Channel.

Downing Street po ua bën gjithashtu të qartë konservatorëve të vijës së ashpër se parlamenti është kundër daljes pa marrëveshje nga blloku evropian e se qeveria do të rrezohet nëse implementon një skenar të tillë.

Megjithatë, këta elementë brenda partisë konservatore kanë

shqyrtuar mënyrat për rrëzimin e May-t, ndërsa atmosfera e brendshme e kësaj force politike përshkruhet si "apokaliptike".

Mijëra protestues që e kundërshtojnë daljen e Britanisë nga Bashkimi Evropian, dolën në rrugët e Londrës me thirrjet "Le të vendos populli", e kërkuar mbajtjen e një referendum të ri.

Pas tre vitesh debate të pafundme, Brexit-it duket sërish i largët dhe një pjesë e politikanëve problemin e gjejnë tek May. "Është e patolerueshme, situata në të cilën jemi, druhem se është ajo problemi", tha Anna Soubry, ligjvënëse pro-Bashkimit Evropian.

"May duhet të largohet, pasi ne na nevojitet një kryeministër i përkohshëm, i cili ta vendosë vendin në plan të parë", shtoi ligjvënësjë që së fundi i braktisi konservatorët pikërisht për shkak të mosmarrëveshjeve mbi politikën e Brexitit dhe iu bashkua grupit të pavarur të porsaformuar.

Shefja e ekzekutivit duhet të bindë ligjvënësit të mbështesin planin e saj për largim nga Bashkimi Evropian, pasi BE-ja propozoi shtyrje të Brexit-it përtej datës së përcaktuar paraprakisht, 29 marsit./REL

KRYEMINISTRES SË ZELANDËS SË RE I VIJNË MESAZHE KËRCËNUESE



"Ju e keni rradhën"

Një javë pas sulmit terrorist që tronditi Zelandën e Re, ku 50 persona u qëlluan me armë për vdekje teksa po faleshin në një xhami, në rrjetet sociale kryeministrja e vendit ka marrë mesazhe kërcënuese. Sipas mediave vendase mesazhet ishin të shoqëruara me foto armësh mbi të cilat shkruhej: Ju e keni radhën.

Jancinda Ardern ka denoncuar menjëherë kërcënimet në polici, ndërsa janë mbyllur nga autoritetet dhjetëra llogari Twitter-i, nga të cilat erdhën kërcënimet. Mediat gjithashtu thotë se mesazhet kishin edhe përmbajtje urrejtjeje anti-islamike. 28-vjeçari Brenton Tarrant qëlloi me armë në xhaminë Al Noor dhe Linwood në Christchurch, duke shkakuar një rën prej masakrave më të mëdha që ka përjetuar vendi.

Vdes spiuni izraelit që kishte arrestuar "arkitektin" e Holokaustit

Rafi Eitan, ish-agjenti i shërbimit sekret të Izraelit, i cili e kishte gjetur dhe e kishte zënë nazistin Adolf Eichmann, ka vdekur në moshën 92 vjeçare. Eitan e kishte udhëhequr një ekip prej tetë personash, të cilët kishin udhëtuar në Argentinë në vitin 1960. Ky ekip e kishte arrestuar në mënyrë sekrete nazistin Eichmann dhe e kishin dërguar atë në Izrael për ta gjykuar. Ai vlerësohet si një nga baballarët e shërbimit izraelit të inteligjencës. Eichmann ishte një nga arkitektët kryesorë të Holokaustit, vrasjes masive dhe sistematike të gjashtë milionë hebrenjve nga Gjermania naziste. Ai ishte shpallur fajtor dhe ishte dënuar me vdekje me varje në litar në vitin 1962. Shërbimi sekret izraelit, Mossad, ishte njoftuar nga një prokuror i Gjermanisë Perëndimore se Adolf Eichmann është gjallë dhe është duke u fshehur në Argentinë, shkruan BBC. Kryeministri i Izraelit, Benjamin Netanyahu, tha se Eitan është një nga heronjtë e inteligjencës izraelite dhe se ai ishte shok i ngushtë i tij. Eitan u lind në Palestinë në vitin 1926, ndërsa familja e tij e ka prejardhjen nga Rusia. Ai është rritur në Ramat Hasahron që ndodhet në veri të Tel Avivit.

Çfarë përmban raporti i Prokurorit Mueller?

Me dorëzimin e raportit, procesi hetimor i Prokurorit Mueller është efektivisht i përmbyllur, por nuk u jep fund telasheve ligjore për Presidentin. Gjatë muajve të fundit, Prokurori Mueller ka deleguar pjesë të hetimit të tij tek degët e prokurorëve të Shteteve të Bashkuara

Amerikanët janë në pritje të detajeve të hetimit të Prokurorit të Posaçëm Robert Mueller për ndërhyrjen në zgjedhjet presidenciale të vitit 2016. Ai e dorëzoi raportin e tij konfidencial të premtën tek Prokurori i Përgjithshëm William Barr, i cili informoi në vazhdim udhëheqësit e Kongresit nëpërmjet një letre ku shprehet se "mund të kem mundësinë t'ju njoftoj për gjetjet kryesore të prokurorit të posaçëm, ndoshta që këtë fundjavë".

Por, ndërsa zoti Barr po njihet me raportin, sipas zëdhënësit të Departamentit të Drejtësisë, përmbledhja që ai do t'i dërgojë Kongresin do të vonohet me të paktën edhe një ditë. Një zëdhënësi i Shtëpisë së Bardhë, Hogan Gidley, tha se Shtëpia e Bardhë nuk e ka marrë raportin dhe se as nuk është informuar rreth tij.

Duke përsëritur qëndrimin e Sekretares së Shtypit të Shtëpisë së Bardhë, Sarah Sanders, të shprehur

të shtunën, ai tha se hapat e mëtejshëm në këtë proces janë në dorën e zotit Barr.

PIKËPYETJET KRYESORE

Disa nga pikat kryesore që zoti Mueller, ish-drejtor i FBI-së, do të trajtonte janë: A bashkëpunoi me rusët fshehurazi Donald Trump, apo ndihmësat e tij, për të dëmtuar fushatën e demokrates Hillary Clinton në vitin 2016, nëpërmjet emailëve të vjedhura nga Komiteti Kombëtar Demokrat dhe nga drejtuesi i fushatës elektorale Clinton? Apo pati presidenti i ardhshëm thjesht fatin të përfitojë prej taktikave dashakeqe të Rusisë? A u mundua ai të sabotonte hetimin që pasoi, për të mbrojtur veten dhe këshilltarët e tij politikë dhe ndihmësat? Hetimet kanë sjellë ngritje akuzash për 37 individë dhe entitete, shumica e tyre operative rusë që nuk janë kapur. Shtatë persona, ndër ta pesë ish-bashkëpunëtorë të Presidentit Trump, janë vetëdeklaruar fajtorë, si dhe pesë janë dënuar me burg. Ndër rastet e nivelit të lartë janë ish-këshilltari i sigurisë kombëtare Michael Flynn, që u vetëdeklarua fajtor për mashtrim të FBI-së rreth bisedave të tij me ambasadorin e Rusisë, si dhe Paul Manafort, ish-kreu i fu-

shatës elektorale Trump, i cili u dënua rishtazi për një sërë veprash penale. Pak përpara dorëzimit të raportit hetimor, pati spekulime të shumta se prokurori i posaçëm do të sugjeronte ngritje akuzash të mëtejshme, por nuk u ndërmorën hapa të tjera ligjore përpara dorëzimit të raportit tek Departamenti i Drejtësisë. Me dorëzimin e raportit, procesi hetimor i Prokurorit Mueller është efektivisht i përmbyllur, por nuk u jep fund telasheve ligjore për Presidentin. Gjatë muajve të fundit, Prokurori Mueller ka deleguar pjesë të hetimit të tij tek degët e prokurorëve të Shteteve të Bashkuara, ndër to edhe Distrikti Jugor i Nju Jorkut, ku prokurorët kanë filluar tashmë hetime të veçanta për Organizatën Trump dhe entitete të tjera të grupit Trump.

NË ÇFARË STADI GJENDET ÇËSHTJA?

Është ende e panjohur nëse raporti Mueller do të sjellë shpagimin për Presidentin, apo ngritjen e akuzave për shkarkimin e tij nga Kongresi, apo ndonjë alternativë të rrëmuishme të ndërmjetme.

Në bazë të ligjit, është Prokurori i Përgjithshëm Barr që vendos nëse dokumenti do t'i bëhet i ditur



Kongresit dhe publikut, dhe nëse po, cilat pjesë të tij.

Presidenti Trump e ka quajtur në mënyrë të përsëritur hetimin e prokurorit të posaçëm një "gjueti shtrigash" dhe ka këmbëngulur vazhdimisht se nuk ka prova të bashkëpunimit të tij me rusët.

Ndërsa Presidenti ka thënë se "nuk e ka problem" nëse raporti bëhet publik, ka gjasa të ketë shkëmbime të konsiderueshme ligjore mes Shtëpisë së Bardhë, Departamentit të Drejtësisë, avokatit personal të zotit Trump, si dhe Kongresit, përpara se pjesë të raportit, apo i gjithi, të bëhen publike.

Rregullorja i kërkon Prokurorit Mueller të paraqesë një "raport konfidencial" të gjetjeve të tij tek Prokurori i Përgjithshëm, i cili duhet të "njoftojë" Kongresin për këtë zhvillim.

Por, nuk ka asnjë parashikim ligjor që e detyron atë të informojë publikun.(VOA)

Nën moton „Lajpcigu lexon“ ka hapur dyert Panairi i Librit në Lajpcig. Kosova prezantohet për herë të parë si shtet, kurse Shqipëria kërkon të zgjerojë më shumë kufijtë letrarë drejt perëndimit

PANAIRI I LAJPCIGUT - VENDE TË VOGLA, DURIM I MADH

Pranvera është stina e librit në Lajpcig. 82.000 vizitorë brenda dy ditësh, 2500 botues dhe më shumë se 3.600 autorë. Me këto shifra mund të mburret Panairi i Lajpcigut (Leipziger Buchmesse), festa e dytë më e madhe e librit në Gjermani. Ditët e panairit (21-24 Mars) nuk janë vetëm ditë të takimeve të botuesve apo nënshkrime kontratash. Panairi i Lajpcigut njihet si një pikëtakim i rëndësishëm i autorëve me lexuesit. Nën moton „Lajpcigu lexon“ organizohen qindra lexime autoriale dhe diskutime të drejtpërdrejta të autorëve me lexuesit e tyre.

KOSOVA PËR HERË TË PARË NË LAJPCIG

E ve anta e këtij viti është se Kosova e Kanadaja përfaqësohen për herë të parë në Lajpcig si shtete me standat e tyre. Një financim i Ministrisë së Kulturës së Kosovës me përkujdesjen e ministrit të Kulturës, Kujtim Gashi dhe Bibliotekës Kombëtare në Prishtinë. Në standin e Kosovës, megjithëse nga sipërfaqja jo shumë e madhe, renditeshin 150 tituj, nga 50 botues. Për drejtorin e Bibliotekës Kombëtare, Fazli Gajraku një moment i veçantë. „Hera e parë që provojmë të sjellim botimet e Kosovës në Panairin i Lajpcigut. Koncepti ka qenë të prezantojmë botimet e vitit 2018 dhe ato të këtij viti. Vetë Biblioteka Kombëtare nuk vlerëson, ajo përfaqëson kulturën e botimit, por kemi qenë të kujdesshëm që



përzgjedhja e titujve të bëhet nga referenca të njohura tashmë.”

VIZAT NË ORËT E FUNDIT

Organizimi i këtij prezantimi të parë në Lajpcig nuk ka qenë një sfidë e lehtë. Jo thjesht për vështirësitë teknike që paraqet kjo premierë e letërsisë së Kosovës në Lajpcig. Sipas drejtorit të Bibliotekës Kombëtare të Kosovës, Fazli Gajraku për vende si Kosova që nuk udhëtojnë ende pa viza në BE,

organizimi i evenimenteve të tilla kulturore kthehet në një garë me kohën. Pa vizë nuk ka udhëtim, nuk ka aktivitet.

„Por kishte një vullnet të madh, një vullnet të fortë të Ministrit të Kulturës dhe të Bibliotekës Kombëtare për ta realizuar këtë. Shumë vetë nuk kishin viza dhe i morën ato në orët e fundit para udhëtimit.” Fazli Gajraku nuk harroi të falënderojë ambasaden gjermane në Prishtinë.

FOTO GALERI

Edhe ambasadori i Kosovës në Berlin, Beqë Cufaj e sheh pjesëmarrjen e Kosovës në Lajpcig si një sukses. E sa herë ndodh që të jemi prezentë në lajmet gjermane për suksese, pyet ai. „Është sukses i madh për një vend të vogël. Ministria e Kulturës u angazhua fort për këtë, por duhet të ecim më tej si vend, të krijojmë një imazh tjetër e të jemi më prezentë si kulturë.”

KATALOGU I AUTORËVE MË TË SUKSESSHËM

Shqipëria në Lajpcig - ndërkohë është kthyer në traditë. Në bashkëpunim me rrjetin gjerman të përkthimit „Traduki”, autorët shqiptarë ka vite që jo vetëm prezantojnë veprat e tyre, shkëmbejnë e krijojnë kontakte të reja, ata marrin pjesë edhe në debatin kulturor ballkanik në podiumet e

organizuaru posa ërisht për këtë në standin e „Tradukit”. Këtë vit Ministria e Kulturës kishte sjellë dy autorë të rinj, Saimir Muzhakën dhe Lisandri Kolën që të ishin pjesë e diskutimit në Lajpcig. Fokusi këtë vit ishte drejtuar tek autorët e nderuar me mime, portrete në përmasa të mëdha të këtyre autorëve kishin përkufizuar standin e Shqipërisë. Drejtoresha e Qendrës së Librit në Ministrinë e Kulturës, Mimoza Hysa thekson, se është synuar kthimi në traditë i prezantimit të katalogut të autorëve më të suksesshëm të një viti më parë. „Ky katalog synon t’u propozohet do vit shtëpive të huaja botuese për të lehtësuar komunikimin me letërsinë shqipe.”

Pretendimi - i qartë: Letërsia shqipe kërkon të zgjerojë hapësirën e saj të veprimit. E dihet, se komunikimi letrar i gjuhëve të vogla me botën kulturore përtej kufijve gjeografikë është një rrugë e gjatë. Mimoza Hysa është e vetëdijshme për këtë, megjithëse, kur e dëgjon të flasë me pasion për përkthimin e rolin e tij në prezantimin e letërsisë shqipe, kupton se „fëmija” i saj më i dashur këto vite ka qenë projekti i prezantimit të sa më shumë shkrimtarëve shqiptarë në perëndim.

Lajm i mirë është se ky komunikim ka bërë deri më tani një copë rrugë të mirë drejt afrimit letrar të Shqipërisë me Europën. Lajmi më pak i mirë - rruga që ka mbetur përpara është ende shumë e gjatë. Autorët shqiptarë e dinë shumë më mirë se autorët e tjerë se 'do të thotë fjala durim. (DW)

TRE AUTORË BRENDË TË PAPRITURAVE TË NJË DHOME NË LAJPCING



Brenda katër mureve të undonjëherë ndeshesh me diçka të

pamundur. Të papritur. Rizbulon vetveten dhe ambientin rreth teje.

Në tregimin e Alexander Špatov, Ditëlindja e nënës sime në

Mladost, Dy (botuar në librin me tregime Një mik i huaj, Shtëpia Bo-

tuese eta 2018), një bir bullgar, për herë të parë, sheh prindërit e tij me një sy të tjetër. Protagonistja - një vajzë e re - e Christiani Wetters, tek “Në jetën private jam shumë më mirë se kaq”, merr shumë këshilla nga gjyshi i saj. Ndërsa tregimi i Saimir Muzhakës “I harruari” nderon nënën dhe babain e tij të harruar. Nw hapwsirat e Panairit tw Librit qw po mbahet nw Lajpcing, tre autorët e rinj Saimir Muzhaka, Aleksandar Špatov, Christiani Wetter, me temën “Në jetën time private jam më i mirë se kaq”, moderuar nga Annemarie Türk. Tre autorët kanë folur për përvojën e tyre të re në letërsi, duke marr shkas nga leximet e veprave të njëri-tjetrit.

SI JETONTE 'BABAI' I "DOKTOR ZHIVAGOS"

Nga Olga Carlisle

Më një janar, vendosa ta vizitoja Boris Pastërnakun, dhjetë ditë pasi kisha mbërritur në Moskë. Kisha dëgjuar shumë për të nga prindërit, që e kishin njohur para shumë vjetësh dhe i doja shumë poemat e tij, që i njihja prej viteve të mia të fëmijërisë.

Kisha edhe disa porosi dhe dhurata të vogla me vete për t'ia çuar nga prindërit dhe nga disa admirues të tjerë. Por Pastërnaku s'kishte telefon dhe këtë e zbulova vetëm në Moskë. I përzura mendimet për të bëre një shkrim të plotë, ku do të kishte dhe një shënim i cili do të ishte jo aq personal për shkrimtarin. Frikësohesha, së pari, duke marrë parasysh pikëpamjen e madhësisë së korrespondencës së tij, se ai mund të kishte përpunuar ndonjë lloj forme shmangie standarde të kërkesave të shumta që i bëheshin për ta vizituar. Befas vendosa një gjë të madhe... do t'i shkoja pa e njoftuar fare këtë njeri kaq të famshëm. Së dyti, frikësohesha se Pastërnaku në vitet e mëvonshme nuk do më mbeste në imagjinatë, ashtu si më vinin natyrshëm poezitë e tij (lirikat), impulse të tëra që më hovnin prej fëmijërie.

Prindërit më kishin përmendur se kur e kishin parë Pastërnakun më 1957, pak kohë para se të merrte Çmimin Nobel, ai mbante të hapur zakonisht shtëpinë ditën e dielë-në fakt element i cili përbente një traditë të njohur në mes shkrimtarëve rusë dhe që ruhej si zakoni i tyre edhe kur ata ishin jashtë Rusisë. Kur kisha qenë adoleshente në Paris, prindërit më morën njëherë të takoja shkrimtarin Reizov dhe filozofin e famshëm Berdyayev, pikërisht në mbremjet e të dielës.

Të dielën time të dytë në Moskë, papritur vendosa të shkoja tek ai në Peredelkino. Ishte një ditë e shkëlqyeshme dhe në qendrën e qytetit, ku po qëndronim, bora e freskët shndriste përkundrejt kupolave të arta të Kremlinit. Rrugëve ishin derdhur vizitorë apo familjarë, të cilët kishin mbërritur që nga rrethinat dhe ashtu të mbledhur në mënyrën e tyre të zakonshme fshatareske, ecnin në drejtim të Kremlinit. Shumë syresh mbanin tufa me mimoza të freskëta- që konsiderohej ende një modë e njohur e asaj kohe. Në fakt, në të dielat e dimrit, mbërrinin anije të tëra me mimoza në Moskë. Rusët i blinin ato për t'ia dhuruar njëri-tjetrit ose thjesht për t'i mbajtur për të shënuar solemnitetin e ditës.

Vendosa të merrja një taksì për në Peredelkino, megjithëse e dija mirë se një tren elektrik që vinte nga Stacioni i Trenit të Kievit afër rrethinave të Moskës, afrohej deri



Shtëpia e Pastërnakut është në një nga rrugët e lakuara të qytezës, të cilat të drejtojnë poshtë kodrës drejt një përroi të vogël

aty afër. Papritmas më kapi një si ngut i madh për të shkuar, paçka se e kisha parashikuar edhe kohën e shkuar dëm e që lidhej me atë që moskovitët e njihnin fare mirë dhe që përbente pakënaqësinë e zakonshme të Pastërnakut për të pritur të huajt. Isha përgatitur thjesht t'i jepja porositë dhe pasi ti shtrëngoja dorën të kthehesha rish-tas pas.

Shoferi i taksisë, një djalë i ri që nuk ngjante fare me taksistët e tjerë përreth, më siguroi se e njih-te shumë mirë Peredelkinon. Dhe, që ishte gati rreth tridhjetë kilometra jashtë autostradës së Kievit. Pagesa do të ishte rreth tridhjetë rubla (3 dollarë). Ai dukesh se po e gjente kaq natyrshëm drejtimin sa që mua hera-herës më vinte të dilja dhe të shëtisja pak jashtë në këtë ditë kaq të mrekullueshme me diell.

Por, pretendimi i shoferit se e njih-te mirë rrugën, qëllori të ishte një mburrje e kotë sepse shumë shpejt e humbëm drejtimin. Kishim udhëtuar me një bajagi shpejtësi përgjatë autostradës me katër korsi, pastruar jo vetëm nga bora por edhe nga billboard-ët apo stacionet e karburantit. Nga ana tjetër, kishte fare pak sinjalistikë në rrugët që po përshkonim dhe ato nuk po na dërgonin drejt Peredelkino, kështu që ndalonim kudo, ku kishim mundësi të hasnim dikë, e ta pyesnim për drejtimin. Çdokush ishte miqësor dhe dëshironte të na ndih-te, por dukej qartë se askush nuk e dinte fare se nga binte Peredelkino. Ne vozitëm për një kohë

të madhe në një rrugë të gjatë të ngrirë dhe pa trotuare përmes fushave pafundësisht të bardha. Përfundimisht, u futëm në një fshat që dukej se i takonte një epoke krejt tjetër, e në kontrast të plotë me apartamentet pafundësisht të reja në rrethinat e Moskës-këto ishin të ulëta, shtëpi të stërvjetra me trarë, të cilat kufizonin një si rrugë të drejtë që kalonte në mes. Një sajë që tërhiqej nga kuajt dhe disa gra me shami ishin mbledhur para derës së një kishe druri. Morëm vesh se ishim në një vendndodhje fare afër Peredelkinos. Pas dhjetë minutash duke ecur në një rrugë ku nuk pushonte një erë e lehtë e përmes një gjelbërimit të përhershëm, isha mu përpara shtëpisë së Pastërnakut. Kisha parë fotografi të tij në revista dhe papritmas, ajo u shfaq e gjallë në të djathtën time; kafe, në ballinë disa dritare me ndarje, të cilat qëndronin në një pjerrësi përkundrejt një sfondi me bredha, e cila shikonte mbi rrugën nga e cila ne aksidentalisht ishim futur në qytet.

Peredelkino është një qytet i vendosur shumë afër Moskës me pamje shumë mikpritëse dhe i gëzueshëm në të tilla mesdita me diell. Me aq sa di unë, shumë shkrimtarë dhe artistë jetojnë aty për të gjithë jetën në shtëpitë e siguruar nga shteti dhe, madje tutje ndodhet edhe një shtëpi e madhe pushimi për shkrimtarët dhe gazetarët, e cila menaxhohet nga Bashkimi i Shkrimtarëve Sovjetikë. Por pjesë të tëra të qytetit ende i takojnë artizanëve të vegjël dhe fshatarëve edhe pse nuk ka asgjë "artistike" në atë atmosferën e tyre të zakonshme.

Chukovsky, kritiku i famshëm letrar dhe shkrimtari i librave për fëmijë, jeton aty mes kolegëve të tjerë, në një shtëpi komode dhe mikpritëse, rrethuar me libra. Madje, drejton një bibliotekë të vogël të dashur për fëmijët e qytezës. Constantin Fedin, një nga shkrimtarët më të njohur që janë

gjallë në Rusi, jeton në derën ngjitur Pastërnakut. Ai është tani sekretari i përgjithshëm i Unionit të Shkrimtarëve, një post që deri më tani i takonte Aleksandër Fadeev, që gjithashtu jetonte këtu deri sa vdiq më 1956. Më vonë, Pastërnaku më tregoi dhe shtëpinë e Isaac Babel, në kohën kur ai u arrestua në vitin 1930 dhe nga ku nuk u kthye më kurrë.

Shtëpia e Pastërnakut është në një nga rrugët e lakuara të qytezës, të cilat të drejtojnë poshtë kodrës drejt një përroi të vogël. Në këtë mbasdite me diell, kodra ishte mbushur me fëmijë që bënin ski dhe slita, të grumbulluar bash njësoj si arinjtë prej pellushi. Përgjatë rrugës nga shtëpia e tij ishte një fushë me gardhe të mëdha-një mjedis shoqëror, që kultivohet vetëm në verë; kur tashmë ishte thjesht një shtrirje e gjerë e bardhë, i cila dominohej nga një varrezë e vogël në kodër, ngjashëm me një copë sfondi nga pikturat e Chagall. Varrezat ishin të rrethuara me gardhe druri të pikturuara me blu të ndritshme, kryqëzimet ishin të mbjella në qoshkut e cepave dhe kishte trëndafila të ndritshëm dhe lule artificiale të kuqe, të cilat qëndronin gjysmë të varrosura në borë. Ishte, gjithsesi një varrezë e gëzuar.

Veranda e shtëpisë e bënte të dukej më shumë si hapësira e një shtëpie amerikane e dizetë viteve të shkuara, por përpara të dukej pak edhe si ruse. Ato qëndronin ashtu bashkë afër me njëra-tjetrën dhe të jepnin ndjenjën e një pylli të thellë, megjithëse kishte vetëm pak korije, që ishin ndër to përgjatë qytetit.

E pagova shoferin dhe me drithërimë të madhe shtyva derën e hapur të kopshtit nga rruga dhe iu afrova ngadalë shtëpisë së errët. Në verandën e vogël, nga njëerë anë, kishte një derë me një shënim të zbërdhulur, gjysmë të çjerrë dhe shkruar në anglisht, e cila ishte ngjitur diku shkujdeshim dhe që shkruante: "Jam duke punuar. Nuk

pres askënd. Ju lutem largohuni". Pas një momenti të tërë hezitimi, zgjedha të mos e respektoja, më shumë nga fakti që ajo dukej se ishte e vënë aty prej shumë kohësh të shkuara dhe për shkak të asaj pakos së vogël, që mbaja në duar. Trokita dhe pothuaj aq menjëherë u hap edhe dera-nga vetë Pastërnaku.

Ai mbante një kapele strakhani. Ishte tmerrësisht i bukur; me mollëzat e kërcyera dhe sytë e errëta bashkë me kapelën me qime, që e bënte të dukej sikur kishte dalë nga ndonjë prej atyre përrallave ruse. Pas një ankthi të vazhdueshëm, e cila më kishte përcjellë udhëtimi, papritmas u ndjeva i qetësuar-më dukej se kurrë s'kisha dëshuar se do të takoja vetë Pastërnakun.

U paraqita vetë si Olga Andreev, e bija e Vadim Leonidovitch, duke përdorur mes-emrin e tim eti. Ishte i ndërtuar nga emri i tij i vërtetë dhe ai i babait, një shkrimtar i tregimesh dhe dramaturg, Leonid autori i dramës "Ai që u qëllua me dackë" dhe "Të shtatët që u varën". Andreev është në të vërtetë një emër shumë i zakonshëm në mes të rusëve.

Iu desh gati plot një minutë Pastërnakut, të kuptonte se vija nga jashtë shtetit. Ai më përshëndeti me shumë ngrohtësi, duke marrë dorën mes dy të tija dhe më pyeti për shëndetin e nënës dhe shkrimet e babait si dhe për kujtimet, që kur isha e vogël në Paris, duke kërkuar ngjashmëritë e familjes time në fytyrë. Ai po dilte të bënte disa takime. Nëse do të kisha qenë vetëm një minutë më vonë do ta humbja takimin me të. Më kërkoi të ecja me të-deri në ndalimin e tij të parë, i cili do ishte Klubi i Shkrimtarëve.

Ndërsa Pastërnaku po bëhej gati për të dalë, pata rastin t'i hidhja një sy mobilimit të dhomës së ngrënies, të cilën tash e kisha përpara syve. Që nga momenti kur hyra u godita nga ngjashmëria e këtij mjedisi me shtëpinë e Leon Tolstoit në Moskë dhe që e kisha vizituar një ditë më parë. Atmosfera në të dyja kombinonte me asketizmin dhe mikpritjen dhe që u bë një mënyrë, të cilën mendoja se duhej të ishte karakteristika kryesore e shtëpive të intelektualëve rusë në shekullin e nëntëmbëdhjetë. Pajisjet ishin të rehatshme, por të vjetra dhe pa pretendime. Dhomat dukeshin ideale për përditëmirinë, pra për grumbullimet e fëmijëve apo edhe për jetën studimore. Megjithëse ishte ekstremist e thjeshtë për periudhën e saj, duhet sqaruar se shtëpia e Tolstoit ishte më e përpunuar se kjo e Pastërnakut, ndërsa shkujdesja e treguar rreth elegancës dhe paraqitjes ishte gati e njëjta.

Një grup gazetarësh nga 16 vende të Europës Qendrore e Lindore, vizituan më 7-17 qershor 2015 Republikën Popullore të Kinës, duke përfutur një imazh të plotë e të aktualizuar të arritjeve të saj. Gazeta "Shqip" sjell ekskluzivisht për lexuesit e saj, përshtypjet e një udhëtimit të paharrueshëm, pjesë e iniciativës së "Rrugës së re të mëndafshit", nga e cila pritet të përfitojë edhe Shqipëria

Armand Plaka

Mirëseardhje e përzemërt delegacionit të gazetarëve nga Europa Qendrore e Lindore! Kjo ishte shprehja që na shoqëronte kudo që shkuam bashkë me përkujdesjen e vazhdueshme që programi të përmbushej 100% dhe që të mos mungonte absolutisht asgjë. Dhe në fakt, çdo gjë ishte organizuar në mënyrë perfekte që një grup i madh gazetarësh nga 16 vendet e Europës Qendrore e Lindore (nocioni në anglisht: CEEC), nga Estonia deri në Shqipëri, të përftonin një imazh sa më të plotë, gjithëpërfshirës, të aktualizuar e realist të Republikës Popullore të Kinës. Udhëtimi, i financuar e mbështetur tërësisht nga Ministria e Jashtme e Kinës, ishte pjesë e axhendës së paracaktuar muaj më parë, që lidhet me planet e qeverisë kineze për atë që tashmë prej pak vitesh njihet si "Rruga e re e mëndafshit", apo iniciativa "Një brez një rrugë". Parimi i paritetit ishte mbajtur mirë parasysh për të gjitha vendet, duke hedhur pas krahëve diferencat në numër popullsie mes tyre, çka në një situatë tjetër do të bënte që Shqipëria – le të themi – të mos përfaqësohej në të njëjtin numër me Poloninë apo Hungarinë. Pas disa andrallave të vogla në aeroporte, mbërrimë në Shanghai, fama e të cilit nuk ka nevojë për koment. Sidoqoftë, rikonjicioni në terren i atyre që kishim dëgjuar qysh në fëmijëri për Parisin e Lindjes, nisi të jepte frytet e para. Kur u nisa, i bëra një premtim vetes se në reportazhin të cilin me domosdo s'do ta lija pa shkruar në faqet e gazetës "Shqip" pas vizitës 10-ditore në Kinë, do përçndroheshja thujse tërësisht tek objektivat ekonomikë, bazuar vetëm në shifra e numra të thatë, duke dashur të shmang politizimet, historinë, kulturën apo dhe elozhet e falënderimet e rastit që në këto raste janë thujse të pashmangshme. Por në mes të udhëtimit tonë, ndërsa mbërrita në kryeqytetin e provincës së Henanit, Zhengzhou, nisa ta rikonceptoj tërësisht idenë fillestare që pata në kokë. Shkak u bënë mbresat që

KINA - PËRTEJ RRUGËS SË RE TË MËNDAFSHIT



po na linte një qytet, i cili ishte ngritur thujse plotësisht i ri në dhjetë vitet e fundit, me një imazh tërësisht modern, për të cilin shumë nga kolegët përtej shakave do të thoshin se atë do të ishte e vështirë që ta ndërtoje qoftë edhe në 3D e jo më në realitet.

Henan, aty ku nis historia e Kinës

Jo vetëm kaq, por provinca qendrore me popullsinë më të madhe në Kinë, rreth 106 milionë banorë, ishte dhe zemra e kulturës dhe historisë kineze. Do ta kujtoj tashmë vazhdimisht shprehjen e shoqëruesit të grupit tonë në Henan, Guo Yang, i cili, sapo mbërritëm, na pohoi se "nëse doni të mësoni historinë 100-vjeçare të Kinës, shkoni në Shanghai, nëse doni të njihni atë 1000-vjeçare, shkoni në Pekin e nëse doni të mësoni historinë e vërtetë të Kinës, atë mijëra e mijëra vjeçare, atëherë shkoni në Henan". 40 mijë objektet e trashëgimisë kulturore kombëtare të ekspozuara në njërin ndër tre muzetë më të mëdhenj të Kinës, që binte menjëherë në sy për arkitekturën e tij të veçantë, në Zhengzhou, e që përfshinin periudha shumë të hershme arkeologjike, i jepnin tërësisht të drejtë kolegut kinez. Jo rastësisht, në atë rajon ishte çelur edhe tempulli i parë budist i Kinës ("Kali Bardhë" ose BaiMa), religjion të cilin kinezët dhe Lindja e Largët e importuan në fakt nga India, nga e cila morën filozofinë e meditimit "ekstrem". Jo më kot, atje gjendet edhe tempulli më i madh budist e më i vizituar në botë, Shaolin, dhe pak kilometra pranë tij edhe shkolla më e madhe e arteve marciale, atdheu i kung-fusë së famshme, në fakt vetëm njëra ndër 34 të tilla në mbarë territorin e Republikës Popullore.

Cjigantë të teknologjisë e eko-

nomisë

Një risi e vërtetë teknologjike që na u paraqit ishte dhe zona ekonomike aeroportuale e Zhengzhou-së, duke na e bërë edhe më të qartë riorientimin ekonomik të Kinës, e cila po lëviz tashmë nga ajo e orientuar drejt investimeve dhe eksporteve, te zhvillimi endogjen që bazohet në konsum. Zona aeroportuale e Zhengzhou-së, e nisur të ndërtohet në vitin 2013, me një sipërfaqe prej 415 kilometrash katrorë, tashmë nën këtë projekt madhor, merr një rëndësi të veçantë në lidhjet me Kinën dhe Europën. Duke thyer tabunë e vjetër se Kina qendrore pa akses në det e kufij ndërkombëtarë, nuk mund të prodhojë prosperitet, ky projekt është domethënie e zhvillimeve të reja në ekonominë kineze. Provinca Henan, gjatë vitit 2014, me një rritje në raportet eksport-import prej më shumë se 10%, rritje investimesh në nivel prej 6.5% dhe rritje të PBB-së prej 1.6% përbën tashmë një shembull të politikave vizionare. Po ashtu, shembuj të potencës së madhe ekonomike ishin edhe kompania e madhe shtetërore "Citic Heavy Industries", apo ndërmarrje të mbështetjes logjistike e faciliteteve të tjera hekurudhore në qytetin e Zhengzhou-së si "China Railway Engineering Group Co., Ltd", që mendohet se do t'i shërbejnë sidomos rrugës tokësore të iniciativës së re kineze, duke përshkuar shumë rajone e shtete të Euroazisë. Po ashtu, një bilanc për t'u pasur zili përmban edhe kompania e famshme Huawei, të cilën grupimi i gazetarëve nga CEEC pati rast ta vizitonte, e themeluar me një kapital fillestar fare modest në fillim të viteve '80, e që tashmë është një lider në fushën e inovacionit e teknologjisë, duke u bërë e njohur si-

domos në prodhimin e smartfonëve e pajisjeve elektronike të fjalës së fundit.

Ningbo, aty ku nis rrugëtimi detar

Ndërsa përshkuam mijëra kilometra, duke prekur qytete të bregut lindor e juglindor të Kinës si Shanghai, Ningbo, Jiwu, kryeqytetin e provincës së Zhejiang-ut, Hangzhou, atë të Henanit, Zhengzhou, bashkë me lokalitetet që mbartin vlera të trashëgimisë kulturore botërore si Luoyang, Shaolin, Dengfeng dhe së fundmi edhe kryeqytetin e vendit, Pekinin, sytë na shohin shumë panorama të gjelbëruara, por edhe një infrastrukturë gjigante, të re e moderne, duke na bërë të besojmë se puna e atyre njerëzve tashmë me kohë i ka dhënë frytet e veta. Udhëtimi nis nga Shanghai e për tri ditë me radhë nuk na ndahet shiu e mjegulla që na jep një ndjenjë bezdisëse, por një sërë aktivitetesh të zhvilluara në qytetin e Ningbosë, njëri ndër qytetet më të zhvilluara të Kinës dhe qendër e disa ekspozitave e panairëve, të cilave u parapriu një konferencë speciale për investimet kineze në vendet e Europës Lindore e Qendrore, ku mori pjesë edhe një delegacion shqiptar i kryesuar nga zëvendësmministri i Jashtëm, z. Selim Belortaja, i kishin dhënë qytetit një atmosferë të veçantë e tepër miqësore. Shkojmë në pavijonin shqiptar dhe gjejmë të ekspozuara produkte kryesisht agrokulturore, si ftesë paraprake për konsumatorin kinez, për të pranuar e përthithur më shumë nga prodhimet tona. Pala kineze ishte kujdesur që të aplikonte norma falas për evidencimin e ekspozimit e artikujve dhe pjesëmarrja e zyrtarëve të lartë kinezë dhe mediave lokale e atyre qendrore, bënë që të gjitha aktivitetet të përcilleshin në mënyrën e

duhur. Në fund, seria e aktiviteteve u mbyll me një mbrëmje gala, ku në shenjë respekti për mysafirët nga Europa, u luajtën pjesë muzikore klasike e tradicionale nga 16 vendet tona, nga një orkestër e njohur filarmonike vendase, e cila me virtuozytetin e saj, ndezi dukshëm atmosferën në një sallë ku të gjithë pohuan se po ndiheheshin "si mbretër". Moderniteti i atij qyteti dhe hapësirat e mëdha, si dhe zgjerimi i aktivitetit portual, e kanë bërë këtë qytet tashmë një lider jo vetëm rajonal, por edhe simbol të bashkëpunimit ndërkombëtar, nga i cili do mund të përfitonte edhe Shqipëria e rajoni, si pjesë e rrugës detare të iniciativës "një brez, një rrugë". Në një takim me lidhshpinin e qytetit të Jiuu-së u njohëm gjerësisht me arritjet dhe planet për ta bërë këtë qytet që shënon tashmë një rekord botëror në shitblerjen e këmbimit e mallrave e artikujve tregtarë industrialë, një simbol të paharrueshëm të zhvillimit.

Demokracia në Kinë, jo një tabu!

Zyrtarët kinezë e definojnë vendin e tyre dhe sistemin mbi të cilin kanë arritur të jenë ekonomia në zhvillim më e madhe në botë dhe ekonomia globale e dyta në rruzull pas asaj amerikane, si një "vend socialist me karakteristika kineze", duke mos ngurruar aspak që atë që përjetojnë ta cilësojnë edhe si një "demokraci" në mënyrën që ata e konceptojnë këtë term. Pasi në fakt, ndryshe nga ç'mund të mendohet, atje tashmë flitet lirish edhe për sfida të mëdha që përndryshe rezultojnë të jenë sa globale aq edhe lokale, si: varfëria, demokracia, të drejtat e njeriut, ndotja e ajrit etj. Qysh para se të niseshim, ambasadorja e re kineze në Tiranë, Zonja Jiang Yu, theksoi në një takim me gazetarët e medias së shkruar, se: "Ne jemi të ndërgjegjshëm se kemi shumë sfida të mëdha përpara, se na duhet të ndeshemi me varfërinë, të ngremë mirëqenien individuale në atë shkallë që performon edhe shteti", duke shpalosur objektiva të qarta, të detajuara që do të duhet të përmbushen në një afat kohor me shtrirje afatmesëm hap pas hapi, duke përmendur si kufi, 100-vjetorin e themelimit të Republikës Popullore të Kinës dhe po ashtu edhe 100-vjetorin e themelimit të Partisë Komuniste kineze. Më duhet të përmend këtu edhe një fakt sa rrëqethës, aq edhe domethënës. Ndërsa po udhëtonim me njërin nga linjat e brendshme ajrore kineze për të shkuar drejt kryeqytetit të provincës së Henanit, lexova në faqet e "China Daily" një lajm që fliste për një vetëvrasje të fëmijëve të një familjeje në një provincë kineze, ardhur si pasojë e varfërisë ekstreme, por përshtypje më bëri fakti se lajmi ishte botuar duke pohuar të vërtetën shumë të hidhura, për më tepër në një gazetë, e cila rëndom lexohet nga të huajt, pa bërë asnjë përpjekje për ta fshehur.

KARL GEGA, INXHINIERI SHQIPTAR QË NDËRTOI HEKURUDHËN E SEMERINGUT

Më 14 mars të këtij viti u bënë 159 vjet nga vdekja e inxhinierit të famshëm me origjinë shqiptare. Karl Gega qe inxhinier, projektues rrugësh dhe hekurudhash. Njihet sidomos për ndërtimin e hekurudhës së Semeringut, që fillon në Glognic dhe arrin në Myrcushlag

Edhe pjesa më e vështirë dhe spektakolare e kësaj hekurudhe, ajo Erercog-Johanban (hekurudhë e arkidukës Xhovani), Vienë – Trieste, u projektua e gjitha prej tij.

Karl Gega lindi në Venecie nga prindër me origjinë shqiptare. Studioi në Padovë, ku vetëm 17 vjeç mori diplomën në matematikë.

Më pas filloi karrierën e tij si projektues duke ndërtuar rrugë dhe vepra hidrike në krahinën e Venetos. Midis gjërave të tjera ndihmoi në ndërtimin e "Rrugës së Alemanjës", rrugës që nga San Vendemiano, pranë Koneljanos, të çon në Dobiako duke kaluar nëpër Kortina d'Ampeco. Në periudhën 1836-1840 qe mbikëqyrës në Bohemi për ndërtimin e "Hekurudhës Perandor Ferdinandi" që shonte nga Bryni deri në Lundenburg. Në atë kohë (1836-1837) studio edhe botën e hekurudhave në Angli dhe në kombe të tjera europiane.

Në 1942-shin Gega u bë drejtori i përgjithshëm i Südlichen Staatsbahn-it (Hekurudhave Jugore të Shtetit) ku i takoi detyra të projektonte Hekurudhën e ardhshme Jugore, për të cilën ndërmoi një udhëtim studimi në Amerikë. Përvojat që buruan nga ky udhëtim bashkëdikuan jo vetëm në projektimin dhe ndërtimin e Hekurudhës së Semeringut, por edhe në dy botime. Gega e botoi pjesën më të madhe të shkrimeve të tij paralelisht në gjuhët gjermane, italiane dhe franceze.

Pas kthimit të tij në Hekurudhat e Shtetit Austro-Hungarez, u ngarkua me projektimin e hekurudhës jugore, nga Viena në Trieste përmes Gracit, linjë heku-

ÖSTERREICH
160 JAHRE KALTE RINNE VIADUKT

70



rudhore që më pas u pagëzua në nder të arkidukës Giovanni d'Asburgo si "Linja Arkidukë Xhovani", por që kaloi në histori si "Hekurudha Jugore" meqë lidhte kryeqytetin e Perandorsë me jugun.

Në atë periudhë, shumë vetë menduan se përshkrimi hekurudhor i Semeringut ishte teknikisht i ndërlikuar, madje i kotë. Por që më 1848-ën Gega paraqiti një projekt që e kalonte rrugën me lokomotiva normale, pa iu drejtuar kremaljerave. Edhe më parë se të vendosej nisja e punimeve, Gega porositi ndërtimin e lokomotivave të përshtatshme për kapërcimin e pjerrësive të tilla.

Punimet filluan më 1848-ën dhe para përfundimit të tyre, më 1851-shin, mori titullin kalorës ("Ritter"). Kur më 1854-ën hekurudha u përfundua Gega kishte projektuar tashmë një rrjet hekurudhash për krejt perandorinë austriake dhe në vitet në vijim mori shumë detyra të tjera, midis të cilave ndërtimin e pjesëve hekurudhore në Transilvani.

Megjithatë Gega nuk mundi ta shihte përfundimin e kësaj veprë të fundit pasi vdiq nga tuberkulozi në Vienë, më 1860-ën.

Ceremonia fetare është zhvilluar në Katedralen kryesore të Vjenës, Shën-Stefan (Stephansdom), kurse trupi u varros në varrezat e Währinger-it në Vjenë. Më 1887, kur këto varreza u shpërngulën, sarkofagu me eshtrat e Gegës u vendos në panteonin e njerëzve më të shquar të Austrisë, pranë Mozart-it, Beethoven-it,

Schubert-it, Strauss-it, Brahms-it dhe Alois Negrell-it (projektuesit të kanalit të Suezit).

Jeta e Karl Gegës frymëzoi plot

pesë romane. Në vilën e familjes, Vila Allegri Von Ghega në rivierën e Brentës në Oriago ruhet një pjesë e arkivit historik. Gegës Austria

i rezervoi nderin e portretit në kartëmonedhën prej njëzetë shillingash, ndërsa në Trieste, Itali, një rrugë mban emrin e tij.

Sipas autorit Alfred Niel i cili ka shkruar biografine Karl Gega-s në 1977: prejardhja e familjes Ghega është nga Shqipëria. Kjo shpjegohet edhe mekuptimin e fjalës Ghega në gjuhën shqipe, shpjegon Niel. Autori i referohet edhe priftit francesk shqiptar Dr. Phil. Paulin Margjokaj, i cili ka jetuar në Vjenë e që ndoqi gjurmët e prejardhjes së familjes Ghega. Sipas gjurmimeve historike të tij, mbasi në 1478-tën Turqit pushtuan Shkodrën, Venzianet u larguan nga qyteti i Shkodrës duke marrë me vete edhe shumë familje qyteteshkodrane që punen për to. Të gjithë këto shqiptarë janë vendosur në një zonë të qytetit të Venizias dhe thirreshin nga vendasit Gegët / Ghegët. Po kështu edhe studiuesi dhe autori i librit tjetër për Karl Gegën – Wolfgang Straub, sidhe autorë të tjerë e biografë si Gerhard Artl, Günther Dinthobl, Mihaly Kubinnszky, e lidhin prejardhjen e familjes Ghega me Shqiperinë.

Perveç karrierës të pakrahasueshme si inxhinier dhe arkitekt, Karli pa edhe anën tjetër të jetës, atë private, për të cilën nuk ka shumë të dhëna. Ai ishte në përgjithësi njëri i vetmuar, kalonte një jetë të thjeshtë e pa pretendime. Ai banonte i vetëm në qendër të Vjenës, në Bashkinë e parë dhe i pamartuar. Respekti që patën kolegët e punës për të shprehet me fjalët: ishte i dashur me të gjithë, plot me humor, si në ditët e vështira ashtudhe në të mira, ishte ai që dinte gjithmonë të kapërcente situatat e vështira me humorin e tij shumë njerzor që paqësonte e freskonte këdo... Kjo ishte bota e brendëshme e një njeriu me pikëpamje të qarta në jetë e më besim të plotë në aftësitë e veta. Megjithë nderimet që ju banë atij, në shkrimet e ndryshme për te nënvizohet me forcë fakti që mbas mbarimit të hekurudhës, ai u keqtrajtua e u la në harresë nga institucionet qendrore të shtetit, gja që solli deziluzion në personalitetin e tij e si rezultat sëmundje e depresion. Atij ju rishfaq sëmundja e vjetër e mushkrive që i kushtoi edhe jetën. Në këtë kohë të papërshtatshme për te e "transferuen për punë" në një zonë të largët siç ishte Siebenbürgu (vënd afër Detit të Zi). Ai vdiq në moshën 58 vjeçare, i lënë në harresë dhe i anashkaluar nga opinioni.





Historiku i betejës mes Google dhe Bashkimit Evropian

Google u godit nga një gjobë 1.49 miliardë euro ditën e Mërkure dhe është sanksioni i tretë i imponuar nga Bashkimi Evropian në dy vitet e fundit.

Unioni ka gjobitur Google me 4.34 miliardë euro vitin e kaluar dhe 2.4 miliardë euro në 2017-ën për praktikatat që i konsideron jo konkurruese.

Komisioni Evropian tha se Google, një divizion i Alphabet, ka përdorur AdSense për të ndaluar palët e treta nga reklamimi i rivalëve të kompanisë.

Mëposhtë kemi përshkruar momentet kyçe që çuan në acarimin e marrëdhënieve mes Google dhe Bashkimit Evropian:

20 Mars 2019 – BE gjobit Google me 1.49 miliardë euro për shërbimin AdSense
18 Korrik 2018 – BE gjobit me 4.34 miliardë euro Google për sistemin operativ Android pas një hetimi tre vjeçar.

27 Korrik 2017 – Google merr gjobën e parë prej 2.4 miliardë eurosh për dëmtimin e konkurrentëve në shërbimin e shitblerjeve online.

14 Korrik 2016 – Bashkimi Evropian akuzon shërbimin e shitblerjeve të Google. Gjithashtu akuzon kompaninë se ka dëmtuar konkurrentët me produktin AdSense.

26 Prill 2016 – BE dërgon një ankesë pranë Google duke cituar praktikatat antikonkurruese me Android përballë prodhuesve të telefonëve Android.

15 Prill 2015 – BE hap hetimin ndaj Google Android

15 Prill 2015 – BE akuzon Google për bllokimin e konkurrentëve në shërbimin e shitblerjeve

Shtator 2014 – Joakim Almunia, Komisioneri i atëhershëm i Konkurrencës, tha se hetimi ndaj Google nuk do të mbarojë përpara mbarimit të mandatit të tij.

Shkurt 2014 – Google ofron më shumë konçensione BE për kërkimin online
2013 – Grupi lobimit FairSearch padit Google Android pranë Komisionit Evropian

25 Prill 2013 – BE kërkon mendimin e rivalëve dhe përdoruesve për konçensione të Google

3 Prill 2013 – Google ofron konçensione për kërkimin online dhe AdSense por pa pranuar praktikatat antikonkurruese.

30 Nëntor 2013 – Komisioni Evropian hap hetimin ndaj Google për abuzimin e pozitave dominuese në kërkimin online.

INTERNETI MBUSH 30 VJEÇ, POR PËR SHUMË VAZHDON TË JETË NJË ËNDËRR

Interneti, me emërtimin zyrtar "World Wide Web" (www) feston 30 vjetorin. Më 12 mars 1989, Tim Berners Lee prezantoi studium në laboratorin CERN të Gjenevës që përbënte bazën teorike të internetit dhe më pas hyri në histori. Duke u bazuar në atë dokument, faqja e parë web u hap në vitin 1991 dhe nga ajo kohë interneti shpërtheu duke i hapur dyert një bote të re komunikimi, informimi, pune dhe krijimtari.

Megjithatë këto dyer vazhdojnë të jenë të mbyllura për shumë njerëz. Janë mbi dy miliardë persona për të cilët interneti është i paaritshëm sepse nuk kanë mundësi ekonomike ose sepse nuk ka investime teknologjike në vendet ku jetojnë. Nga ana tjetër, shqetësimi më i madh për përdoruesit e internetit ka të bëjë me sigurinë dhe privatesinë.

Dokumenti që Berners Lee i paraqiti mbikëqyrrësit të tij në CERN të Gjenevës quhej "Information Management: a Proposal" (Menaxhimi i Informacioni: një Propozim), që shërbente për të lehtësuar shpërndarjen e të dhënave shkencore mes



shkencëtarëve.

Brenda dy vitesh Berners-Lee dhe një studiues tjetër, Robert Cailliau, ndërtuan themelet e Web-it duke krijuar edhe browser-in e parë, programi që shërben për të shfletuar faqen në internet. Fizikani që u vlerësua me titullin "Sir" nga mbretëresha Elisabeta II, aktualisht është drejtori i konsorciumit të "World Wide Web", me të cilin vazhdon të punojë për zhvillimin e internetit.

Pikërisht kjo organizatë, në saj të përpunimit të të dhënave të OKB-së, disa muaj më parë vërtetoi një rënie të numrit të personave në internet, me një ngadalësim drastik në vitin 2015, pavarësisht rritjes që vjen nga Kina. Sipas analizës së fundit të bërë nga "Alliance for Affordable Internet" (Aleanca për Internet të përballeshëm), të futesh në internet vazhdon të jetë një ëndërr për dy miliardë persona në botë, ku më të prekurit janë të varfërit dhe gratë.

NJË SHKOP I RI DIRIGJENTI OFRON SHPRESA PËR MUZIKANTËT E VERBËR

Një kompani që krijon instrumente muzikore të modifikuara ka gjetur mënyra origjinale për t'ia përshtatur krijimet e saj nevojave të personave me aftësi të kufizuara. Kompania ka krijuar një shkop dirigjenti që u jep mundësi edhe personave me probleme shikimi të ndjekin lëvizjet e shkopit. Kjo arritje hap portat për muzikantë të verbër që duan të luajnë me orkestra:

Dirigjenti qëndron përballë orkestrës dhe me lëvizjet e shkopit drejton muzikantët. Ata ndjekin çdo lëvizje të tij për të marrë sinjale nëse do të luajnë më ngadalë, më lehtë, me ritëm apo me intensitet.

Por muzikantët e verbër, si violinistja Abie Baker, e kanë të pamundur të ndjekin lëvizjet e shkopit:

"Në të kaluarën ndiqnim tingujt përreth. Isha pjesë e seksionit të violinave dhe dëgjoja kur të tjerët ngrinin instrumentin për të filluar interpretimin, unë bashkohe-

sha me ta me hamëndje. Pa dyshim nuk ishte një mënyrë e përsosur, sidomos kur luan një pjesë të shpejtë kur nuk ka kohë për të humbur".

Tani shkopi Haptic ndihmon instrumentistët e verbër të ndjekin dirigjentin. Shpikësi Vahakn Matossian shpjegon se shkopi ka ndjesorë që kapin edhe lëvizjen më të vogël të dirigjentit:

"Shkopi ndjen lëvizjen e dorës. Ndjen këndet, ngritjet e uljet. Ndjen si ndryshimet e lehta ashtu edhe më të forta," shpjegon shpikësi.

Informacioni transmetohet me sinjale radioje në aparatet që mbajnë në kyçin e dorës ose të këmbës muzikantët. Aparati përcjell dridhje të ndryshme për të informuar muzikantët mbi udhëzimet që përcjell dirigjenti.

Pianisti Kevin Satizabal thotë se kjo shpikje ka sjellë një ndryshim rrënjësor për

muzikantët e verbër:

"Teknologjia të lidh me lëvizjet e dirigjentit. Kjo nënkupton se tani orkestrat nuk do të kenë më justifikime për të mos punësuar muzikantë të verbër, pasi teknologjia tani u mundëson këtyre muzikantëve të jenë plotësisht të integruar," thotë pianisti.

Shkopi Haptic është ende në fazën e provës në duart e instrumentistëve dhe dirigjentëve si Ewan Campbell:

"Gjatë përdorimit arrij të ndjej sinjalet dhe përshtas lëvizjet që bëj pasi shërbejnë si sinjale. Besoj se shumë shpejt do të zhvilloj një stil dirigjimi që nuk bazohet shumë në konceptin pamor, por në konceptin ndjesor".

Shpikësi shpreson se kompania e tij, "Human Instruments" do të arrijë ta hedhë në treg shkopin e ri të dirigjentit vitin e ardhshëm.





DASHI 21. mars - 20. prill

Dite e begate do jete kjo e sotmja për ata qe janë ne një lidhje. Do ndiheni aq mire saqë here pas here nuk do ju besohet qe jeni ne një ëndërr. Beqaret do jene te shoqërueshëm dhe te qeshur. Ata do marrin disa propozime ne momentet qe me pak e presin. Ne planin financiar do ju mungoje realizmi dhe ka rrezik te hidhni disa hapa te gabuara. Beni kujdes sa me shume.



DEMI 21. prill - 21. maj

Gjerat ne çift do ju ecin mire sot ju te dashuruarve dhe mund te mendoni te hidhni edhe disa hapa me tej. Do ndiheni ne çdo moment te lumtur. Beqaret do ndiheni keq sepse sado qe do mundohen, nuk do arrijnë dot ta gjejnë dashurinë e vërtetë. Ne planin financiar do keni një dite te vështirë. Do ju duhet patjetër te bëni investime prandaj te ardhurat do dobësohen ndjeshëm.



BINJAKET 22. maj - 21. qershor

Do jeni sharmante sot ju te dashuruarit dhe marrëdhënia ne çift ka për te qene e shkëlqyer. Partneri do ndihet me shume fat qe ju ka ne krahu. Beqaret do kenë një dite euforike dhe te mbushur me takime, por nuk do preferojnë te hedhin hapa te rëndësishme. Financat do dini si t'i menaxhoni si duhet dhe nuk do keni as problemin me te vogël. Vazhdoni ne këtë rrugë.



GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik

Dite e jashtëzakonshme ka për te qene kjo e sotmja për ata qe janë ne një lidhje. Jo vetëm qe do dashuroheni pa dorashka dhe do i shprehni ndjenjat, por do filloni edhe projekte qe do ju bëjnë te kaloni me tepër kohe me njeri-tjetrin. Beqaret duhet te reflektojnë mire para se te bëjnë zgjedhje. Buxhetin duhet ta keni me tepër ne vëmendje pasi situata ne një moment mund te marre tatëpjetën.



LUANI 23. korrik - 22. gusht

Nëse jeni ne një lidhje, duhet te tregoheni me tolerante dhe te kuptueshëm ne mënyrë qe te mos keni probleme dhe vështirësi. Beqaret do kenë një dite me te bukur dhe me interesante. Ata do realizojnë takime mbresëlënëse me personat me shume vlera. Nuk duhet ta lënë rastin t'iu ike nga duart. Ne planin financiar do merrni vendime te rëndësishme dhe situata do vije duke u përmirësuar.



VI R G J E R E S H A 23. gusht - 23. shtator

Dite pozitive ka për te qene kjo e sotmja për te dashuruarit. Do keni një marrëdhënie te mire me partnerin dhe do i shihni gjerat me optimizëm. Beqaret do bëjnë mire te presin edhe pak kohe para se te hedhin hapa sepse po tentuan sot, shpejt do zhgënjehen. Ne planin financiar situata do mbetet e njëjtë si me pare. Nuk do arri ni dot te keni përmirësime.



PESHORJA 24. shtator - 23. tetor

Do e respektoni ne maksimum partnerin tuaj sot dhe do jeni dakord me gjithçka qe ai do ju thotë. Do filloni te programoni një te ardhme fantastike. Beqaret duhet te qartësohen njëherë me vetëm për atë qe duan te bëjnë e me pas te marrin vendime. Ne planin financiar do përballeni me vështirësi te njëpasnjëshme dhe nuk do arri ni dot te kryeni investime.



AKREPI 24. tetor - 22. nëntor

Sot do ju duhet te bëni edhe sakrifica ju te dashuruarit vetëm qe te keni një marrëdhënie te mire me partnerin. Çdo çast te lire do qëndroni pranë tij dhe do bëni plane. Beqaret do jene sensuale dhe do marrin ftesa e propozime nga persona te ndryshëm. Duhet t'i shfrytëzojnë te gjitha, por pa u nxituar për vendime. Me shpenzimet tregohuni sa me te matur qe te mundeni.



SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor

Dite shpërthyes dhe here pas here e mbushur me debate te forta do jete kjo e sotmja për te dashuruarit. Kërkoni këshilla nga te afërmit sepse mund t'iu ndihmojnë. Beqaret nuk do takojnë personat e duhur dhe do vazhdojnë te mbeten te vetmuar. Ne planin financiar do i keni idetë te qarta dhe nuk do bëni asnjë lloj çmendurie. Vazhdoni te kurseni nga pak dhe e ardhmja ka për te qene e mire.



BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar

Marrëdhënia juaj me partnerin nuk ka për te qene gjithë kohës e mire. Here pas here mund te keni edhe debate te forta me te dhe do mendoni për ndarje. Mire është qe te mos nxitoheni. Beqaret duhet ta shfrytëzojnë sa te mundin lirinë e tyre dhe nuk duhet ta privojnë veten nga asgjë. Ne planin financiar shume gjera do fillojnë te stabilizohen dhe nuk do keni probleme.



UJORI 21. janar - 19. shkurt

Mos bëni gjera te gabuara sot sepse partneri nuk do jete gati te mbylle një sy dhe te beje sikur nuk ka ndodhur gjë. Silluni sa me mire qe te mundeni. Beqaret do kenë plot aventura, por aspak mundësi për te filluar lidhje serioze. Do jete ne dorën e tyre nëse do përfitojnë apo jo. Cjendja financiare do konsolidohet me shume se me pare dhe do jeni gati te bëni edhe investime gjigande.



PESHQIT 20. shkurt - 20. mars

Dite shume e qete ka për te qene kjo e sotmja për ata qe janë ne një lidhje. Nuk do keni as problemin me te vogël me partnerin dhe mund te filloni te mendoni edhe për te ardhmen. Beqaret do ndihmohen nga tjetër dhe do gjë ka për t'iu ecur mire. Me shpenzimet tregohuni vigjilente nëse nuk doni te mbeteni shpejt pa para. Duhet menduar edhe për te ardhmen.



KOHA	IFYER	BERNARDIN PALAJ	KORNIZA	AKTORI JAPONEZ, AKIRA	VEPËR E AUTORIT NË FOTO	BËJ GJUMË QËNDISJE ME BEDENA	LIDHJE E AFËRT
I BËRITTA ME BROHORI							
BANOR I NË QYTETI I STRIAN						FRANCA VARGU I TETË NOTAVE (SH.)	
FLUORI		NJERI ME VLERA TE MEDHA BALERINA KOSOVARE, HYSA					
MORALE					Ë POLITIKANI ESTONIAN, PAET	CELËS (ANG.) AKTORJA MEKSIKANE, DE LA PARA	
NUMËR			ËMBËLSIRË BEKTASHINJSH NIKELI				FUTBOLLISTI ITALIAN, FRANÇESKO
FE				MAJMIJ I FAMILJES SË LEMURIT SHTRESË			
LLOJ LIKERI HUNGAREZ					MAKSIMALATINE, "AB ..." (NGA VEZA) 51 ROMAK		
ARGJENDI			LLOJ LULEJE (SH.) SULFURI				
NGJARJE E RASTIT						PËREMËR VETOR	

ZGJIDHJET: P, MAKE, IKER, TUND, HADI, MARIT, TEMË, FLE, I BROHORITA, OPATJAS, F, MADHËSHTOR, ETIKE, E, KI, NR, ASHURET, DIN, PRIMAT, UNIKUM, OVO, AG, AZALEAT, RASTËSI, TI.

Shumë i lehtë **Sudoku** mesatar

2		3	8		1	6		9		1		9	7		2		
		9				8			6			5			7	3	
				9				3						4			8
5			4		6			3		5		8		6	3	2	
		6		7		9											
3			9		8			5		6	2	7			1		5
	8			3					9			1					
		5				3				8	1			3			7
9		1	6		2	5		7			6		5	9			8

Shumë i lehtë: 243851679, 179364852, 658297431, 597416283, 826573914, 314928765, 482735196, 765149328, 931682547. Mesatar: 314978265, 698512734, 527364918, 759846321, 143295876, 862731459, 935187642, 481623597, 276459183.

Nënë e bijë pilote në një ekuipazh



Një nënë dhe vajzë me profesion pilote kanë tërhequr vëmendjen e internetit pasi një foto e tyre u publikua derisa

udhëtonin bashkë në kabinën e një 'Delta Boeing 757'. Udhëtari John Watret po fluturonte nga Los Anxhelos në Atlanta

me 16 mars. Ai u befusua kur dëgjoji se ekuipazhi i tij i fluturimit ishte një nënë bashkë me vajzën e saj. Wendy Rexon dhe vajza e saj, Kelly ishin dy pilotët që po drejtonin avionin. Fotoja e tyre bashkë në kabinën e avionit u shpërnda shumë në internet, ku mori mbi 42 mijë pëlqime. Shumë përdorues të mediave sociale thanë se ishin të frymëzuar nga kjo foto derisa lavdëronin nënë dhe vajzën për bashkëpunimin. "Ky është lajmi më mahnitës, e më i mrekullueshëm se ndonjëherë. Nëna dhe unë kurrë nuk do të kishim udhëtar se bashku si ekuipazh. Nuk mund të pajtohemi as për tu futur në një makinë", shkruante një përdorues i internetit. Një tjetër përdorues, që gjithashtu ishte një pilot, ndau fotografinë e tij bashkë me djalin duke udhëtuar se bashku si ekuipazh.

Këngëtari vetëvritet gabimisht në videoklip, i shkrep arma në xhep



Këngëtari i njohur, Justin Carter, është vetëvrasë gabimisht me një armë zjarri gjatë realizimit të një videoklipi në apartamentin e tij. 35-vjeçari po filmonte në Hjuston, Teksas, kur arma u shkrep aksidentalisht nga xhepi dhe i shpoi syrin e kokën, raportojnë mediat e huaja. Gjithashtu thuhet se ende nuk dihet se pse po përdorej një armë e mbushur me fishekë në një prodhim muzikor. Ndërkohë pas vdekjes së Carter, menaxheri dhe miku i tij Jamie Scott Ruckman publikoi në faqen personale të këngëtarit një mesazh ku falenderonte të gjithë fansat për mbështetjen e tyre. Gjatë dy muajve të fundit, Carter kishte postuar pesë video muzikore të prodhuara në mënyrë të pavarur në kanalën e tij në "Youtube". Ndërkohë këngëtari nga Teksas sapo kishte nënshkruar edhe një kontratë me "Triple Threat Management" dhe së shpejti do të ndërmerre edhe turin e tij të parë në 10 shtete.



Siri Lanka i thotë "Stop!" thatësirës. Krijon shiun artificial

Siri Lanka ka kryer me sukses një test për krijimin e shiut artificiale në një rajon malor ku kultivohet çaji. Vendi e ndërmoi këtë masë pasi kjo zonë goditet shpesh nga thatësira. "Një aeroplan i Forcave Ajrore spërkati kimikate në rreth 8.000 metra lartësi, duke nxitur shiun artificial, i cili mbushi rezervuarët në tokë në mënyrë që sigurojnë ujë për të gjeneruar energji hidroelektrike", tha Ushantha Ĕarnakumara, një zëdhënës në ministrinë e energjisë. Ministria vendosi të krijonte shira artificiale sepse sezoni i thatë ka ulur nivelet e ujit në rezervuarët që përdoren për të gjeneruar energji hidroelektrike. Tailanda ka dërguar një ekip të veçantë

për të nisur projektin, pasi më parë ka siguruar njohuritë teknike, për të krijuar shira artificiale. "Shirat artificiale të së premtes ishin një projekt pilot dhe ishte shumë i suksesshëm," tha Ĕarnakumara. Ai shtoi se ministria do të vazhdojë të krijojë shirat artificiale gjatë dy javëve të ardhshme në malin e ishullit, ku gjenerohet shumica e energjisë hidroelektrike të vendit. Siri Lanka kryesisht energjinë elektrike e prodhon nga shirat. Gjatë stinëve të thata, vendi përballet me ndërprerje të shpeshta të energjisë. Shumica e hidrocentraleve më të mëdhenj janë ndërtuar në mal, ku rriten lloje të çajit me famë botërore.

Vdes, por kthehet në jetë pasi mjekët e çojnë në morg



Një postier vdiq për 21 minuta pas një ataku kardiak por mrekullia ndodhi me të. Joao Araujo u kthye në jetë ndërsa mjekët po e çonin më morg. 48-vjeçari u përmbys në timonin e makinës kur po shkonte të merrte gruan në punë. Pas 6 orësh përpjekje për ta shpëtuar, mjekët i thanë familjes së tij se Joao vdiq. Por kur infermierët po e dërgonin nga reanimacioni në morg vunë re se po lëvizte. Pas analizave u zbulua se qarkullimi i gjakut në zemrën e tij u kthye në mënyrë spontane. Mjekët thanë se nuk ka një shpjegim të saktë se çfarë ndodhi me të.

421 – Themelohet qyteti i Vene-cias.

1306 - Robert Bruce kurorëzohet mbret i Skocisë.

1409 – Hapet Këshilli i Pizës.

1668 – Fillon gara e parë me kuaj në SHBA.

1700 – Anglia, Franca dhe Holanda ratifikojnë Traktatin e dytë të Asgjësim-it.

1776 – Kongresi Kontinental autorizon një medalje për Xhorxh Uashingtonin.

1802 – Franca, Holanda, Spanja dhe Anglia nënshkruajnë Traktatin e Amiensit për paqe.

1807 – Fillon komunikacioni hekurudhor në Angli.

1821 – Greqia fiton pavarësinë nga Perandoria Osmane (Dita Kombëtare).

1895 – Trupat italiane pushtojnë Abisininë (Etiopinë).

1937 – Italia dhe Jugosllavia nënshkruajnë Traktat për mos të sulmuar (Pakti i Beogradit).

Duelt me armë janë të ligshme në Paraguai, nëse të dy personat janë regjistruar si dhurues të gjakut.



Një vit në Venerë

është sa 224 ditë në Tokë, por një ditë në Venerë është sa 243 ditë në Tokë.

Kështu që një ditë është më e gjatë se një vit.

Kur fitoni ose humbni peshë, qelizat e juaja të yndyrës nuk zhduken, ata thjeshtë ndryshojnë madhësinë e tyre.



FEJESA

I thotë vajza të dashurit të saj: "I dashur, kur po fejoheja se mjaft kohë na ka shkuar?" Aiii zemër jemi plakë ne, s'na merr askush më", i thotë ai.



Kafshët janë të rrezikshme kur janë të uritura, ndërsa njeriu është i rrezikshëm kur është i ngopur.

(Alija Izetbegović)